Fatjona Lleshi

## PARADOKSET E LACAN-it

Çfarë të mëson analiza, nuk mund të fitohet me asnjë rrugë tjetër, as nga studimi, as nëpërmjet ndonjë ushtrimi tjetër spiritual. Përndryshe, pse ta marrësh mundimin? Mos do të thotë gjë kjo se u dashka të heshtim për këtë dije? Se, meqë kjo qenka kaq e veçantë për gjithsecilin, nuk paska mënyrë për ta shpjeguar, për t'ia përcjellë së paku parimet, dhe ndonjë pasojë? Lacan-i e shtroi këtë çështje dhe iu përgjigj me më shumë se një mënyrë. Në *Seminarin* e vet, ai argumenton shtruar. Te *Shkrimet*, kërkon të demonstrojë, dhe e mundon shkronjën si t'i vijë për mbarë. Pastaj kemi edhe konferencat e tij, bisedat, improvizimet. Këtu gjithçka ecën më shpejt. Është fjala që t'i kapësh opinionet në befasi, në mënyrë që t'i bësh pastaj për vete. Këto i kemi quajtur *Paradokset* e tij.

Kush flet këtu? Një mjeshtër i urtësisë, por i një urtësie pa paqësim, i një anti-urtësie, sarkastike, sardonike. Gjithsekush është i lirë ta përdorë këtë si përçuese drejt idesë së vet.

Kjo seri, që në krye iu kushtua materialeve të pabotuara, do të botojë në vijim pjesë të zgjedhura të veprës.

Jacques Lacan

# MËSIMET E MIA

*Përktheu nga frëngjishtja:*
Ardian Vehbiu

Onufri

*Titulli në origjinal:*
JACQUES LACAN
MON ENSEIGNEMENT
CHAMP FREUDIEN
COLLECTION DIRIGÉE PAR JACQUES-ALAIN ET JUDITH MILLER

© Éditions du Seuil, octobre 2005
Për gjuhën shqipe, © Onufri, 2012

ISBN 978-9928-164-21-6

PRINTED AND BOUND IN ALBANIA BY ONUFRI

Shtëpia Botuese Onufri
Rr. "S. Gabrani", Tiranë, Tel/Fax 00355 4 2220 017; 2270 399
http: //www.Onufri.com; E-mail: onufri@abissnet.al

# PROLOG

Tani që marr penën të shkruaj, ndihem e ngashëryer: për herë të parë, një tekst i Lacan-it po botohet në shqip, falë Ardian Vehbiut dhe Jolka Nathanailit, të cilët i falënderoj nga zemra për këmbënguljen dhe kujdesin, së bashku me botuesin që po kryen, në këtë rast, një akt kulturor dhe një gjest qytetërues.

Në fakt, pikërisht Jacques Lacan-it i detyrohemi, për atë që zbulimi freudian mundi ta ruajë natyrën e vet subversive; meqë psikanalistët, pas Luftës II Botërore, për arsye koniunkturale, ia lanë atij zbulimi tehun t'i ndryshkej krejt, duke e reduktuar në një kapitull të shpëlarë të psikologjisë së përgjithshme, krejt të pranueshëm nga ligjërimi universitar... Nëse Freud-i, megjithatë, na ka mësuar diçka është që ne mbajmë sot përgjegjësi për iluzionet tona. Në fakt, gjithsekush, falë dëshirës së Freud-it, që mundi të rrokë se çfarë i shtyn simptomat e neurotikëve, ëndrrat e njerëzve, shakatë e tyre dhe lapsuset të rikthehen: ne nuk jemi zotër në shtëpinë tonë, dhe, që pas Freud-it, jemi në gjendje t'i njohim koordinatat e dëshirës që na vë në lëvizje, duke

i kushtuar vëmendje asaj çka këto pengime të vogla nënkuptojnë për secilin prej nesh; e pavetëdijshmja nuk resht së shpalosuri në këto ngjarje, që duken si të padëmshme.

Në krye, Lacan-i thjesht u kujdes që t'i merrte seriozisht tekstet e Freud-it, të cilave u kushtoi seminaret e veta të hershme, para një publiku, në ato vite, të kufizuar në pak psikanalistë të rinj, por që pastaj erdhën duke u shtuar, deri ditën kur Shoqata Ndërkombëtare e Psikanalizës ia ndaloi të japë mësim dhe të edukojë analistët. Atëherë ai themeloi shkollën e vet (në 1964) dhe e vazhdoi seminarin, para një auditori gjithnjë e më të ndjeshëm ndaj zhvillimit të pasojave të zbulimit freudian dhe leksioneve të klinikës analitike, që përpunonte Lacan-i prej tyre.

Siç e thotë edhe Lacan-i vetë, në konferencën e fundit të botuar këtu, s'është fjala që ai të përmblidhte mësimet e tij -- dhe as që ta bëja unë këtë, *a fortiori*. Në po këtë konferencë, Jacques Lacan-i e shpjegon psenë: ai s'e përsëriti kurrë veten (edhe pse e mbajti seminarin e vet për 30 vjet), dhe sa herë që ka folur, është përpjekur të shpjegojë një vështirësi klinike, një çështje aktuale të praktikës së vet, një problem konjunktural (për shembull, një keqkuptim, ose një saktësim në lidhje me zhvillimet në mësimin e vet).

Nëse sot seminari i Lacan-it është botuar i plotë, nga Jacques-Alain Miller, të cilit ia besoi këtë Jacques Lacan-i vetë, nuk duhet as të harrojmë se Jacques Lacan-i i analizonte rregullisht zhvillimet e mendimit të vet në artikujt që botonte: këto tekste janë përmbledhur në *Écrits*, botuar në 1966 dhe në *Autres écrits*, përgatitur nga Jacques-Alain Miller në 2001.



Urojmë që një ditë këto dy vëllime t'u jepen shqiptarëve në gjuhën e tyre – ato janë përkthyer në shumë gjuhë, sikurse seminaret dhe një numër i madh përmbledhjesh konferencash si kjo e tanishmja, që i ka mbledhur Jacques-Alain Miller-i.

Më duhet të shtoj edhe se, pa përmbledhur gjë, teksti *princeps* i mësimit të Jacques Lacan-it titullohet «Funksioni dhe fusha e ligjërimit dhe e gjuhës në psikanalizë»; ata që merren me mendimin e Lacan-it, e njohin si «ligjërata e Romës», meqë u mbajt në Kongresin e vitit 1953, tek Instituti i Psikologjisë i Universitetit të Romës.

Kjo ligjëratë shquan tre regjistra: Realen, Simbolikën dhe Imagjinaren, të cilave u qaset duke u nisur nga Simbolikja. Në vijim, Lacan-i do ta orientojë klinikën duke privilegjiuar Realen dhe mund të thuhet se teksti i vitit 1949, me titull "Stadi i pasqyrës si formues i funksionit të Unit", i paraqitur në Kongresin XVI ndërkombëtar të psikanalizës në Zyrih, tregon se në ç'mënyrë përcaktohet, Imagjinarja, nga Tjetri i gjuhës, duke pasur parasysh se dallimi mes "Uni-t" dhe "Unë (*Je*)" ka të bëjë me atë që ky " njeri i vogël" flitet që para se të lindë, pavarësisht nëse dëshirohet apo jo.

Këtë gjendje të subjektit Lacan-i do ta quajë "parlêtre", me një neologjizëm që tregon mospajtimin thelbësor mes trupit dhe gjuhës.

Pikërisht këtë e shpërfillin dhe këmbëngulin ta shpërfillin neuroshkenca dhe metodat e kushtëzimit të lidhura me "protokollet" që kanë pushtuar botën bashkëkohore, me pëlqimin e OBSh-së; dhe DSM-ja, versioni i pestë i së cilit pritet të dalë në 2013.

Nuk dua t'ua jap mësimin në formë pilule; mendoj se ashtu do ta kisha të vështirë.

Ndoshta ajo do të vijë më pas. Ashtu përfundon gjithçka. Pasi ke qenë i vdekur për një kohë të gjatë, e sheh veten të përmbledhur në tre rreshta të një teksti shkollor – edhe pse, në rastin tim, nuk jam dhe aq i sigurt se ç'tekst shkollor do të ishte ky. Nuk e parashikoj dot se çfarë tekstesh shkollore do të flasin për mua, sepse nuk parashikoj dot asgjë për të ardhmen e mësimit tim, ose të psikanalizës, për ta thënë ndryshe. Ne nuk dimë se çfarë do të bëhet kjo psikanalizë. Sa më takon mua, unë shpresoj që të bëhet diçka, por nëse kjo është rruga që ka marrë, nuk e di.

Që këtej, mund të shihni edhe se titulli që kam zgjedhur, "Vendi, origjina dhe qëllimi i mësimit tim," mund të fillojë të marrë

një kuptim që është më tepër se thjesht përmbledhës. Çfarë po përpiqem të arrij, është t'ju bëj pjesë të diçkaje që është duke u kryer, që është në lëvizje e sipër, diçkaje të pambaruar dhe që ndoshta do të mbarojë vetëm kur të kem mbaruar unë, me kusht që të mos më ndodhë ndonjë nga ato aksidentet e bezdisshme që të bëjnë t'i mbijetosh vetes. Por gjithsesi, po ju them se nuk po shkoj në atë drejtim.

Është si me një disertacion të ndërtuar mirë, që ka një pikënisje, një fillim dhe një fund. Dhe unë them 'vendi', sepse vërtet na duhet të fillojmë nga një fillim.

## 1

Në fillim nuk është origjina. Është vendi.

Ka në sallë ndoshta dy ose tre vetë që e kanë një farë ideje për këtë avaz të vjetër timin. Vend është një term që unë e përdor shpesh, sepse në fushën me të cilën merren ligjëratat e mia – ose ligjërata ime, nëse dëshironi – gjenden referime të shpeshta ndaj vendit. Nëse doni të dini se ku jeni, në këtë fushë, është mirë të keni diçka që fusha të tjera, më të sigurta me veten, e quajnë topologji; si dhe të keni një



farë ideje se si është ndërtuar skeleti i temës ku brendashkruhet ajo, për të cilën po flasim.

Natyrisht, unë nuk do të shtyhem kaq larg sonte, sepse unë kategorikisht refuzoj që t'ua jap mësimin tim në formën e një pilule të vogël. 'Vend' këtu ka një kuptim shumë të ndryshëm nga ç'ka në topologji, në kuptimin e strukturës, kur është thjesht çështja që të dihet nëse një sipërfaqe është sferë apo unazë, meqë çfarë mund të bëhet me njërën nuk bëhet dot me tjetrën dhe anasjelltas. Gjithsesi, këtu nuk është fjala për këtë. 'Vend' mund të ketë kuptim krejtësisht të ndryshëm. Këtu do të thotë vendi se ku kam mbërritur dhe që më vë në një pozicion nga ku mund të jap mësim, sa kohë që ekziston një diçka e tillë si ky mësim.

Tani, ky vend duhet futur në regjistrin e asaj çka është fati ynë i përbashkët. Ti zë atë vend ku të ka shtyrë një akt, ja kështu, nga e djathta ose e majta, thjesht fare. Ja që rrethanat qëlluan të tilla që, të them të vërtetën, unë as që mendoja se ishte e thënë për mua që... por pastaj m'u desh të kapem pas frerëve.

E gjithë kjo sillet rreth faktit që funksioni i psikanalistit nuk është i vetëkuptueshëm dhe

që, kur vjen puna për t'ia dhënë këtij statusin, zakonet, referencën, madje edhe vendin që zë në botë, asgjë nuk është e natyrshme, asgjë nuk është e vetëkuptueshme.

Ekzistojnë vendet për të cilat fola më sipër: vendet topologjike, vendet që kanë të bëjnë me thelbin; pastaj ekziston edhe vendi yt në botë. Ti zakonisht arrin atje me të shtyra. Me një fjalë, kjo të lë pak shpresë. Pavarësisht se sa shumë jeni, gjithnjë do të përfundoni diku, po të keni pak fat. Por jo më tutje se kaq.

Sa për vendin tim, duhet të kthehemi pas, në vitin 1953. Në atë kohë psikanaliza në Francë po përjetonte çfarë mund të quhet një moment krize. Po flitej për të krijuar një mekanizëm institucional, që të rregullonte statusin e psikanalistëve në të ardhmen.

E gjithë kjo, shoqërohej me premtime të bujshme elektorale. Po të përkrahje Filanin, na thuhej, statusi i psikanalistit do të përfitonte pa vonesë gjithfarë privilegjesh zyrtare – sidomos mjekësore.

Siç ndodh zakonisht me premtime kësisoj, asgjë nuk u realizua. Dhe megjithatë, një farë sistemimi u arrit, si rezultat.



Ndodhi që ky ndryshim nuk u erdhi për mbarë të gjithëve, për arsye tejet të rastësishme. Sa kohë që punët ende nuk ishin sistemuar, mund të kishte – dhe pati – fërkime, ose çfarë i quajmë konflikte.

Në mes të kësaj rrokopuje, e pashë veten, së bashku me disa të tjerë, në një barkë shpëtimi. Për dhjetë vjet jetuam me çfarë kishim në bord. Nuk është se na mungonin krejt burimet, nuk është se kishim marrë fund krejt. Dhe në mes të kësaj rrokopuje, pra, ndodhi që çfarë kisha unë për të thënë në lidhje me psikanalizën nisi të marrë një farë rëndësie.

Këto gjëra nuk ndodhin vetvetiu. Mund të flasësh për psikanalizën ashtu, çapraz, dhe është e lehtë të verifikosh se njerëzit vërtet ashtu flasin. Por nuk është kaq e lehtë të flasësh për të nga fillimi në fund të javës, duke u kujdesur që të mos e thuash kurrë të njëjtën gjë dy herë dhe të mos thuash çfarë është tashmë e njohur, gjithë duke e ditur se çfarë është tashmë e njohur ka rëndësinë e vet. Por kur çfarë është tashmë e njohur, të duket ty se lë një çikë për të dëshiruar, të duket ty se është e bazuar në një premisë të rreme, atëherë pasojat janë krejt të tjera.

Të gjithë besojnë se e kanë një ide të mjaftueshme se çfarë është psikanaliza. 'E pavetëdijshmja... ja... është e pavetëdijshmja.' Sot nuk ka njeri që të mos ta dijë se e pavetëdijshmja ekziston. Nuk ka probleme të mëtejshme, objeksione të mëtejshme, pengesa të mëtejshme. Por çfarë është kjo e pavetëdijshmja?

Ne gjithnjë e kemi ditur për të pavetëdijshmen. Natyrisht, ka shumë gjëra që janë të pavetëdijshme dhe, natyrisht, të gjithë i kanë zënë këto gjëra në gojë qëkur në filozofi. Por në psikanalizë e pavetëdijshmja është një e pavetëdijshme që mendon me forcë. Çfarë gëlon, në këtë të pavetëdijshme, është e pabesueshme. Janë mendime ato që gëlojnë, na thonë.

Por prisni pak, prisni. 'Nëse janë mendime, ato s'mund të jenë të pavetëdijshme. Sapo e pavetëdijshmja nis të mendojë, ajo nis edhe të mendojë se është duke menduar. Të menduarit është i tejdukshëm ndaj vetes; ti s'mund të mendosh pa e ditur se je duke menduar.'

Natyrisht, ky objeksion nuk ngre më peshë fare. Jo se njerëzit e kanë ndonjë ide për të qenë



se si mund të hidhet poshtë. Duket se mund të hidhet poshtë, por në fakt nuk mund të hidhet poshtë. Dhe e pavetëdijshmja është pikërisht kjo: një fakt, një fakt i ri. Duhet të fillojmë të mendojmë diçka që mund ta shpjegojë, të shpjegojë se si mund të ekzistojnë gjëra të tilla, si mendime të pavetëdijshme. Kjo s'është hiç e vetëkuptueshme.

Askush nuk është ulur, në fakt, që ta bëjë këtë; dhe megjithatë, kjo është një çështje filozofike madhore.

Do t'ju them që në krye se unë nuk iu qasa kësaj çështjeje kështu. Ndodhi që mënyra si iu qasa unë e kundërshton këtë objeksion me lehtësi, por ky nuk është më vërtet objeksion, sepse tani gjithsekush e ka krijuar mendimin e vet për këtë punë.

Mirë atëherë, të pavetëdijshmen e pranuam, por prapë, edhe shumë gjëra të tjera janë pranuar – të paketuara paraprakisht, dhe siç na i kanë dhënë – dhe rezultati është se gjithkush mendon se e di çfarë është psikanaliza, me përjashtim të psikanalistëve; dhe kjo është vërtet arsye për t'u shqetësuar. Këta të fundit janë të vetmit që nuk e dinë.

Dhe nuk është thjesht puna që nuk e dinë; meqë kjo, deri diku, është justifikuese. Sikur të kujtonin se e dinin, çështja do të ishte serioze dhe psikanaliza vetë nuk do të ekzistonte më. Në fund të fundit, të gjithë do të binin dakord. Psikanaliza? Kjo çështje është mbyllur. Por nuk mund të ndodhë kështu, për psikanalistët.

Dhe këtu gjërat fillojnë të bëhen interesante. Ka dy mënyra për të vepruar, në raste të tilla.

E para është të përpiqesh të jesh *me* të sa më shumë që të mundesh, dhe ta vësh në pikëpyetje. Një operacion, një përvojë, një teknikë për të cilën teknikët janë të detyruar të pranojnë se nuk kanë asgjë ç'të thonë, kur vjen puna për çfarë është qendrore, më thelbësore – tani, kjo do të ishte me interes, apo jo? Dhe do të ngjallte simpati pa masë, sepse ka, tek e fundit, shumë gjëra që lidhen me fatin tonë të përbashkët dhe që paraqiten ashtu, dhe këto janë pikërisht gjërat për të cilat interesohet psikanaliza.

Mirëpo psikanalistët, siç ka dashur fati, kanë marrë gjithnjë qëndrimin e përkundërt. Ata nuk ta thonë haptazi se dinë, por e nënkuptojnë këtë. 'Ne dimë diçka për këtë,



por le të mos e zëmë në gojë. Le të mbetet midis nesh.' Ne hyjmë në këtë fushë të dijes nëpërmjet një përvoje unike që konsiston, thjesht fare, në faktin që i nënshtrohemi ne vetë psikanalizës. Pas kësaj, ti mund të flasësh. Çka nuk do të thotë se po flitet. Mund të flasësh, po të duash; dhe do të doje, sikur të flisje me njerëz si ne, njerëz që janë në dijeni, mirëpo nëse është kështu, atëherë pse?

Prandaj ne rrimë në heshtje edhe me ata që dinë, edhe me ata që nuk dinë, sepse ata që nuk dinë, nuk mund të dinë.

Tek e fundit, ky pozicion është i mbrojtshëm. Disa e kanë adoptuar, çka provon se është i mbrojtshëm. Ndërkohë, edhe kështu, nuk është se u pëlqen të gjithëve. Mirëpo psikanalisti ka një pikë të dobët. Një pikë të dobët shumë të madhe.

Çfarë kam thënë deri tash mund t'ju duket komike, por këto nuk janë dobësi. Është koherente. Vetëm se ka diçka që e bën analistin të ndryshojë qëndrim, dhe këtu nis edhe inkoherenca.

Psikanalisti e di fare mirë se duhet të bëjë kujdes që të mos i dorëzohet tundimit të

vet, prirjeve të veta; dhe në praktikën e tij të përditshme ai kujdeset për këtë. Nga ana tjetër, psikanaliza në kuptimin kolektiv, ose psikanalistët, kur mblidhen bashkë në një grup të madh, në një mizëri, duan të merret vesh se ata i shërbejnë *të mirës së përbashkët.*

Megjithatë, ata tregojnë kujdes të madh që të mos kalojnë, menjëherë, nga kjo 'e mirë e përbashkët' tek e mira e individit, e një pacienti të veçantë, sepse përvoja u ka mësuar se t'u duash njerëzve të mirën shpesh shkakton efekt të kundërt. Për fat të mirë, këtë ide e kanë nxjerrë gjithsesi vetë, nga eksperienca.

Në fakt, psikanalistët i afrohen shumë rolit të propagandistit kur merren me botën përjashta, edhe pse njerëzit do të bënin mirë ta dinin se nuk u bëhet aq mirë të tjerëve thjesht duke ua dashur të mirën. Kjo mund t'u shërbente.

Tani, sa kohë që përfaqësohen si profesion, psikanalistët duan të jenë në krahun e së drejtës, në krahun fitimtar. Dhe për ta provuar këtë, duhet të vërtetojnë se çfarë bëjnë, çfarë thonë, është zbuluar diku, është thënë tashmë, është diçka me të cilën mund të ndeshesh.



Kur mbërrin në një udhëkryq të ngjashëm, në shkenca të tjera, ti thua diçka të ngjashme, dhe pikërisht: se kjo nuk është ndonjë gjë e re, se këtë e kanë menduar të tjerë tashmë.

Prandaj edhe nëe vëmë këtë të pavetëdijshme në marrëdhënie me jehona të vjetra, duke e fshirë atë vijë ndarëse e cila do të na linte të shihnim se e pavetëdijshmja freudiane nuk ka fare të bëjë me çfarë quhej 'e pavetëdijshme' para Freud-it.

Fjalën e kanë përdorur edhe më parë, por karakteristikë e konceptit nuk është që e pavetëdijshmja është e pavetëdijshme. E pavetëdijshmja nuk është karakteristikë negative. Ka shumë gjëra në trupin tim për të cilat unë s'jam i vetëdijshëm, por që nuk bëjnë fare pjesë në të pavetëdijshmen freudiane. Edhe pse trupi interesohet për të herë pas here, kjo nuk do të thotë se e pavetëdijshmja freudiane lidhet ndonjëfarësoj me çfarë bën trupi në mënyrë të pavetëdijshme.

Jua jap këtë shembull, sepse nuk dua të dal shumë nga tema. Më lini të shtoj edhe se disa shkojnë deri aty sa të thonë se seksualiteti për të cilin flasin është po ai seksualitet për të cilin

flasin biologët. Absolutisht fare. Këto janë sheqerosje, si ato që ia bën shitësi blerësit.

Që prej Freud-it e këtej, ekipi i psikanalistëve ka bërë propagandë në një stil të tillë, sheqerosës. Kanë folur për të mirën [*le bon*], sikurse edhe për mirëdashjen të cilën e ceka më sipër. Kjo u është bërë natyrë e dytë psikanalistëve. Këta, kur janë me njëri-tjetrin, çështjet vërtet me rëndësi, që i shqetësojnë vërtet dhe që mund të çojnë në konflikte serioze mes tyre i trajtojnë si çështje për ata që dinë. Por kur u flasin njerëzve që nuk dinë, u thonë gjëra që shërbejnë si hyrje, ose si për t'i joshur. Kjo është praktikë standard, pjesë e stilit psikanalitik.

Si pozicion, ky mund të qëndrojë. Nuk futet në sferën e çka mund ta quajmë si koherente, por tek e fundit ka shumë gjëra në botë që mbijetojnë si të atilla. Është pjesë e diçkaje që është bërë gjithnjë brenda një regjistri të caktuar dhe që, jo më kot, e unë e kam përshkruar si 'propagandë'. Ky term ka një origjinë tepër specifike në histori dhe në strukturën sociologjike. Është *Propaganda fidei*. Është emri i një ndërtese diku në Romë,



ku gjithkush mund të hyjë dhe të dalë. Pra, këtë bëjnë ata dhe këtë kanë bërë gjithnjë. Çështja është nëse mund të mbrohet kjo, kur është fjala për psikanalizën.

A është psikanaliza thjesht dhe vetëm një terapi, një melhem, një jakí, një kurë magjike, ose edhe diçka që mund të përshkruhet njëfarësoj si kurë? Në vështrim të parë, pse jo? Vetëm se psikanaliza nuk është aspak e këtillë.

Më parë duhet të pranojmë se, nëse ka qenë ashtu, do të na duhej të pyesnim veten se ç'na detyron ta përdorim meqë, nga të gjitha jakitë, kjo është më e vështira për t'u duruar. Megjithatë, nëse njerëzit pranojnë t'i nënshtrohen torturës që të vijnë të takohen me dikë tri herë në javë për vite me radhë, kjo duhet të ndodhë ngaqë ka një farë interesi në vetvete. Se pse ndodh kjo, nuk e shpjegojmë dot duke përdorur fjalë që s'i marrim vesh, të tilla si'transferencë'.

Tani gjendemi tek dera. Dhe mua vërtet më duhet të nis nga fillimi fare, ose të provoj t'jua sheqeros edhe unë, duke bërë sikur kujtoja se ju dinit diçka për psikanalizën.

Isha i detyruar t'ju sillja disa prova në krye. Asgjë nga çfarë po them këtu nuk është e re.

Jo vetëm nuk është e re, por ia bën "mu" fare. Gjithë bota e vë re, pa mundim, se gjithçka që thuhet për psikanalizën nëpërmjet shpjegimeve *ad usum publicum* është sheqerosje. Askush nuk dyshon për këtë, meqë, pas një farë kohe, mund ta dallosh sheqerosjen sa herë që e dëgjon.

Tani, çudia është që jemi në 1967, dhe kjo gjëkafsha që nisi, pak a shumë, në fillim të shekullit ose, të themi, katër ose pesë vjet më parë se aq, nëse duam të shtyhemi pak më larg në kohë, dhe nëse vërtet duam ta quajmë 'psikanalizë' çfarë bënte Freud-i kur ishte vetëm – kjo gjëja, pra, është këtu akoma.

Megjithë llafet e bukura, psikanaliza është gjallë e shëndoshë, madje edhe gëzon një farë respekti, një farë prestigji, një lloj efekti të pranisë që është krejt i pazakonshëm, po të kemi parasysh kërkesat që shtron mendësia shkencore. Herë pas here, shkencëtarët mërziten, protestojnë dhe ngrenë supet. Por diçka mbetet, në kuptimin që ata njerëz që janë në gjendje të bëjnë komentet më përçmuese për psikanalizën do të përmendin, herë të tjera, këtë apo atë fakt ose diçka tjetër, këtë



apo atë parim ose edhe precept psikanalitik, do të citojnë ndonjë psikanalist ose do t'i referohen të fituarit të një përvoje të caktuar, sikur kjo të ishte përvoja psikanalitike. Kjo të bën të mendosh, gjithsesi.

Ka pasur shumë sheqerosje në histori por, po ta shohim këtë me kujdes, do të vëmë re se asgjë nuk ka vazhduar dot kaq gjatë. Duhet të ketë diçka këtu, diçka që psikanaliza e ruan, diçka që ia jep këtë dinjitet, ia jep një farë peshe. Kjo është një diçka që psikanaliza e ka ruajtur mirë, dhe në një pozicion që unë e kam cilësuar ndonjëherë me mbiemrin që meriton: 'ekstraterritorial.'

Ia vlen që ta vrasim mendjen për këtë. Gjithsesi, që këtej do të hymë në çështjen që po përpiqem të parashtroj këtu.

Ka ende njerëz që nuk kanë asnjë ide fare se çfarë është psikanaliza; që nuk janë pjesë e saj, por që kanë dëgjuar për të dhe kanë dëgjuar gjëra kaq të këqija, sa ata e përdorin termin kur duan të gjejnë një emër për një mënyrë veprimi të caktuar. Këta do të të tregojnë libra me tituj si *Psikanaliza e Alsace-Lorraine-s* ose *Psikanaliza e Tregut të Përbashkët.*

Ky është një hap paraprak, por të paktën ka meritën që e pohon shumë qartë, dhe jo me më shumë referencë se ç'duhet, misterin që rrethon disa prej fjalëve që përdoren, fjalë që kanë efektin e tyre shokues, që kanë kuptim, që të bëjnë të mendohesh pasi i ke dëgjuar dhe të fillosh të bësh pyetje. Fjala 'e vërtetë', për shembull. Çfarë është 'e vërteta'?

Ja pra, 'psikanaliza' është një nga këto fjalë. Në fillim, gjithkush e ndien se ajo ka një kuptim shumë të veçantë dhe, mbi të gjitha, se e vërteta, në këtë rast, nyjëtohet me anë të një mënyre përfaqësimi që i jep fjalës 'psikanalizë' stilin e vet dhe i jep detyrën e vet të dytë, nëse mund të shprehemi kështu.

E vërteta, në këtë rast, është ekzaktësisht e njëjtë me imazhin mitik që e përfaqëson. Është diçka e fshehur në natyrë, e cila shfaqet që andej në mënyrë fare të natyrshme, duke dalë nga pusi. *Del*, por jo vetëm. Ajo *flet*. Thotë gjëra, zakonisht gjëra që nuk i prisnim. Ja çfarë dëgjojmë kur themi: 'Të paktën e dimë të vërtetën për këtë punë. Dikush po na i rrëfen të gjitha, të lara e të palara'. Për këtë flasim, sa herë që flasim për 'psikanalizë', ose kur i



referohemi asaj diçkaje që i jep psikanalizës peshë; përfshi këtu edhe efektin e duhur korrelativ, të cilin e quajmë efekti surprizë.

Një nga studentët e mi më tha një herë, kur ishte i dehur – ky ka ca kohë që është gjithnjë i dehur meqë, herë pas here në jetën e tij, ka gjëra që dalin jashtë përdorimit – se unë isha si Jezu Krishti. Po tallte bythën, apo jo? Nuk diskutohet. Unë s'kam gjë të përbashkët me atë mishërim. Unë i ngjaj më shumë Ponc Pilatit.

Ponc Pilati ishte pa fat, sikurse jam unë. Ai tha një herë diçka që është vërtet e thjeshtë për t'u thënë: "Çfarë është e vërteta?" Ishte pa fat, ia bëri këtë pyetje Së Vërtetës vetë. Kjo e futi në lloj-lloj telashesh, dhe nuk i ka mbetur emër i mirë.

Mua më pëlqen shumë Claudel-i. Është një nga dobësitë e mia, meqë unë nuk jam katolik. Claudel-i, me gjeninë e vet parashikuese që nuk i mungonte kurrë, i shtoi Ponc Pilatit ca vite jetë.

Kur Pilati dilte shëtitje, thotë ai, sa herë që i qëllonte të kalonte para një idhulli – në kuptimin që i jep idhullit Claudel-i, natyrisht – të thuash se idhulli qenkësh diçka e

Jo vetëm nuk është e re, por ia bën "mu" fare. Gjithë bota e vë re, pa mundim, se gjithçka që thuhet për psikanalizën nëpërmjet shpjegimeve *ad usum publicum* është sheqerosje. Askush nuk dyshon për këtë, meqë, pas një farë kohe, mund ta dallosh sheqerosjen sa herë që e dëgjon.

Tani, çudia është që jemi në 1967, dhe kjo gjëkafsha që nisi, pak a shumë, në fillim të shekullit ose, të themi, katër ose pesë vjet më parë se aq, nëse duam të shtyhemi pak më larg në kohë, dhe nëse vërtet duam ta quajmë 'psikanalizë' çfarë bënte Freud-i kur ishte vetëm – kjo gjëja, pra, është këtu akoma.

Megjithë llafet e bukura, psikanaliza është gjallë e shëndoshë, madje edhe gëzon një farë respekti, një farë prestigji, një lloj efekti të pranisë që është krejt i pazakonshëm, po të kemi parasysh kërkesat që shtron mendësia shkencore. Herë pas here, shkencëtarët mërziten, protestojnë dhe ngrenë supet. Por diçka mbetet, në kuptimin që ata njerëz që janë në gjendje të bëjnë komentet më përçmuese për psikanalizën do të përmendin, herë të tjera, këtë apo atë fakt ose diçka tjetër, këtë



apo atë parim ose edhe precept psikanalitik, do të citojnë ndonjë psikanalist ose do t'i referohen të fituarit të një përvoje të caktuar, sikur kjo të ishte përvoja psikanalitike. Kjo të bën të mendosh, gjithsesi.

Ka pasur shumë sheqerosje në histori por, po ta shohim këtë me kujdes, do të vëmë re se asgjë nuk ka vazhduar dot kaq gjatë. Duhet të ketë diçka këtu, diçka që psikanaliza e ruan, diçka që ia jep këtë dinjitet, ia jep një farë peshe. Kjo është një diçka që psikanaliza e ka ruajtur mirë, dhe në një pozicion që unë e kam cilësuar ndonjëherë me mbiemrin që meriton: 'ekstraterritorial.'

Ia vlen që ta vrasim mendjen për këtë. Gjithsesi, që këtej do të hymë në çështjen që po përpiqem të parashtroj këtu.

Ka ende njerëz që nuk kanë asnjë ide fare se çfarë është psikanaliza; që nuk janë pjesë e saj, por që kanë dëgjuar për të dhe kanë dëgjuar gjëra kaq të këqija, sa ata e përdorin termin kur duan të gjeinë një emër për një mënyrë veprimi të caktuar. Këta do të të tregojnë libra me tituj si *Psikanaliza e Alsace-Lorraine-s* ose *Psikanaliza e Tregut të Përbashkët.*

Ky është një hap paraprak, por të paktën ka meritën që e pohon shumë qartë, dhe jo me më shumë referencë se ç'duhet, misterin që rrethon disa prej fjalëve që përdoren, fjalë që kanë efektin e tyre shokues, që kanë kuptim, që të bëjnë të mendohesh pasi i ke dëgjuar dhe të fillosh të bësh pyetje. Fjala 'e vërtetë', për shembull. Çfarë është 'e vërteta'?

Ja pra, 'psikanaliza' është një nga këto fjalë. Në fillim, gjithkush e ndien se ajo ka një kuptim shumë të veçantë dhe, mbi të gjitha, se e vërteta, në këtë rast, nyjëtohet me anë të një mënyre përfaqësimi që i jep fjalës 'psikanalizë' stilin e vet dhe i jep detyrën e vet të dytë, nëse mund të shprehemi kështu.

E vërteta, në këtë rast, është ekzaktësisht e njëjtë me imazhin mitik që e përfaqëson. Është diçka e fshehur në natyrë, e cila shfaqet që andej në mënyrë fare të natyrshme, duke dalë nga pusi. *Del*, por jo vetëm. Ajo *flet*. Thotë gjëra, zakonisht gjëra që nuk i prisnim. Ja çfarë dëgjojmë kur themi: 'Të paktën e dimë të vërtetën për këtë punë. Dikush po na i rrëfen të gjitha, të lara e të palara'. Për këtë flasim, sa herë që flasim për 'psikanalizë', ose kur i



referohemi asaj diçkaje që i jep psikanalizës peshë; përfshi këtu edhe efektin e duhur korrelativ, të cilin e quajmë efekti surprizë.

Një nga studentët e mi më tha një herë, kur ishte i dehur – ky ka ca kohë që është gjithnjë i dehur meqë, herë pas here në jetën e tij, ka gjëra që dalin jashtë përdorimit – se unë isha si Jezu Krishti. Po tallte bythën, apo jo? Nuk diskutohet. Unë s'kam gjë të përbashkët me atë mishërim. Unë i ngjaj më shumë Ponc Pilatit.

Ponc Pilati ishte pa fat, sikurse jam unë. Ai tha një herë diçka që është vërtet e thjeshtë për t'u thënë: "Çfarë është e vërteta?" Ishte pa fat, ia bëri këtë pyetje Së Vërtetës vetë. Kjo e futi në lloj-lloj telashesh, dhe nuk i ka mbetur emër i mirë.

Mua më pëlqen shumë Claudel-i. Është një nga dobësitë e mia, meqë unë nuk jam katolik. Claudel-i, me gjeninë e vet parashikuese që nuk i mungonte kurrë, i shtoi Ponc Pilatit ca vite jetë.

Kur Pilati dilte shëtitje, thotë ai, sa herë që i qëllonte të kalonte para një idhulli – në kuptimin që i jep idhullit Claudel-i, natyrisht – të thuash se idhulli qenkësh diçka e

neveritshme – meqë, besoj unë, ai e kishte ngritur çështjen e së vërtetës pikërisht aty ku nuk duhej ta kishte bërë ose me Të Vërtetën vetë, sa herë që i qëllonte të kalonte para një idhulli, barku i idhullit hapej dhe dukej se ishte fjala vetëm për një kumbará.

E pra, diçka e tillë më ka ndodhur mua. Ju nuk keni ide se çfarë efekti kam unë në idhujt psikanalitikë.

Le të fillojmë edhe një herë.

Duhet t'i marrim gjërat me radhë, natyrisht. Hapi i parë, është i së vërtetës. Pas gjithçkaje që ka thënë psikanaliza për të vërtetën, ose çfarë mendohet se ka thënë qëkur ka nisur të flasë, ajo nuk i bën më kujt përshtypje. Natyrisht.

Kur diçka është thënë e stërthënë, bëhet pjesë e një vetëdijeje të përgjithshme. Siç thoshte Max Jacob-i, dhe siç jam përpjekur unë ta riprodhoj në fund të njërit prej shkrimeve të mia, 'e vërteta është gjithnjë e re', dhe që të jetë e vërtetë, duhet të jetë e re. Prandaj duhet ta kuptoni se çfarë thotë e vërteta, nuk thuhet njëlloj siç e përsërit ligjërimi i përditshëm.

Pastaj, ka disa gjëra që kanë ndryshuar.

E vërteta psikanalitike ishte se kishte diçka jashtëzakonisht të rëndësishme në fund të saj,



në gjithçka që sendërgjohet kur vjen puna për interpretimin e së vërtetës, dhe pikërisht jeta seksuale.

Është e vërtetë kjo apo jo?

Nëse është e vërtetë, ne duhet të dimë nëse kjo është kështu, ngaqë qëlloi në kulmin e epokës viktoriane, kur seksualiteti ngrinte aq peshë në jetën e gjithsecilit sa ç'ngre sot në jetën e të gjithëve.

Mirëpo, prapë se prapë, diçka ka ndryshuar. Seksualiteti është bërë shumë më publik. Në fakt, unë nuk besoj se psikanaliza pati gisht këtu. Tani, le të themi se, se nëse psikanaliza përdoret për ndonjë qëllim çfarëdo, dhe është pikërisht kjo që po them, atëherë ajo nuk është psikanalizë vërtet.

Hë për hë, referimi ndaj seksualitetit, në vetvete, nuk është në gjendje të nxjerrë në pah çfarë ishte e fshehur, për çka po flisja më lart. Seksualiteti është lloj-lloj gjërash, ditarët, rrobat, mënyra si sillemi, mënyra si e bëjnë djemtë dhe vajzat me njëri-tjetrin, një ditë të bukur, në ajër të pastër, në mes të pazarit.

*Sa vie sexuelle* duhet shkruar me një drejtshkrim të posaçëm. Unë ua kështilloj me

forcë të bëni atë ushtrimin, i cili ju kërkon t'i shkruani ndryshe fjalët. *Ça visse exuelle.* Ja këtu kemi arritur.

Si ushtrim, është shumë domethënës, madje edhe shumë aktual. Zoti Derrida e ka shpikur tashmë gramatologjinë, për të ngashënjyer të gjithë ata të cilëve u pëlqejnë këto gjëra, ata që sot mendojnë se, thjesht ngaqë gjuhësia është ngatërruar me këmbët e veta, duhet konsideruar si dështim. Duhet t'i gjejmë aplikime, gramatologjisë. Provoni të luani me drejtshkrimin; është një mënyrë për t'i trajtuar ambiguitetet, dhe jo fare e kotë. Po ta shkruani formulën *ça visse exuelle*, do t'ju sqarohen shumë gjëra, siç do ta shihni vetë. Madje mundet t'ju shkrepë ndonjë shkëndijë në mendje.

Fakti që *ça visse exuelle* tregon se ka shumë pështjellim, kur vjen puna për subjektin e së vërtetës psikanalitike.

Psikanalistët e dinë mirë këtë, doemos, prandaj merren me gjëra të tjera. Tani në rrethet psikanalitike nuk dëgjon më të flitet për seksualitet. Po t'i hapësh, revistat psikanalitike janë gjërat më të dëlira në botë. Në to nuk gjen



më historira me seks. Këto histori ua kanë lënë gazetave të përditshme. Ato merren me punë që kanë implikime morale largvajtëse, si p.sh. instinkti i jetës. Ah, le të jemi *instinktivistë* ndaj jetës dhe të mos i zëmë besë instinktit të vdekjes. Siç e shihni, po hyjmë në shfaqjen e madhe, në një mitologji të epërme.

Ka njerëz që vërtet besojnë se janë në kontroll të këtyre gjërave dhe flasin për to sikur të ishte fjala për sende që i përdorim çdo ditë, me ç'rast synimi do të ishte që të ruanim drejtpeshimin mes tyre, tangjencialitetin dhe pikëprerjen e duhur, duke u kujdesur për ekonomi maksimale të përpjekjes.

Dhe a e dini se cili është synimi përfundimtar? Të fitosh çfarë këta e quajnë, gjithë pompozitet, një ego të fuqishme, ose fuqi të egos në mes të të gjitha këtyre si dhe krejt instancave diturore që lidhen me këtë.

Dhe ia dalin mbanë. Bëhen nëpunës të mirë. Kjo është egoja e fuqishme. Duhet të kesh një ego që të durojë shumë, që të jesh nëpunës i mirë. Ata e bëjnë këtë në çdo nivel, në nivelin e pacientëve dhe pastaj në nivelin e psikanalistëve.

Po edhe në qoftë ashtu, ia vlen të pyesësh veten nëse qëllimi ideal i kurës psikanalitike është, vërtet, që ta ndihmosh ndonjë zotëri të fitojë pak më shumë pará se më parë dhe, kur vjen puna për jetën e tij seksuale, të plotësojë ndihmën modeste që ia kërkon bashkëshortes së vet me ndihmën që ia jep sekretarja. Po të ndeshje në ndonjë tip me ca probleme në atë lëmë, ose që thjesht i kish ardhur në majë të hundës nga jeta që bënte, ose që vuante nga ca nga ato frenimet e vogla që mund t'i kesh në nivele të ndryshme, në zyrë, në punë madje edhe në shtrat, kjo do të konsiderohej zakonisht si rezultat i mirë.

Kur të jenë qëruar të gjitha këto, kur egoja të jetë e fuqishme dhe në paqe, kur obsesioni me bythën të ketë nënshkruar një traktat paqeje të vogël me mbiunin, siç thonë, dhe kur të kruarit nga e pavetëdijshmja nuk është dhe aq i fortë, atëherë çdo gjë është në rregull. Seksualiteti është, në fakt, një çështje krejt dytësore në këtë mes.

Miku im i shtrenjtë Alexander – dhe ai ishte vërtet mik, dhe nuk ishte budalla, por ngaqë jetonte në Amerikë iu përgjigj edhe



ai kushtrimit – arriti deri aty sa të thoshte, në thelb, se seksualiteti duhet përfytyruar si veprimtari mbishtesë. Në kuptimin që, kur e ke bërë gjithçka si duhet dhe kur i ke paguar taksat në rregull, atëherë çfarë mbetet, është pjesa e seksualitetit.

Do të ketë pasur diku ndonjë gabim, që punët të kenë mbërritur në këtë pikë. Përndryshe, nuk ka ndonjë shpjegim real për faktin që u desh një shpërthim teorik kaq i madh, para se psikanaliza të zinte vend, madje edhe të ngrinte kryeqendrën e vet botërore atje, dhe pastaj të përuronte këtë modë terapeutike ekstravagante. Ç'nevojë kish për gjithë këtë muhabet, nëse puna kish qenë kështu? Këtu ka diçka që nuk shkon. Ndoshta duhet të kërkojmë diçka tjetër.

Mund të fillojmë duke i thënë vetes se duhet të ketë pasur vërtet një arsye pse seksualiteti dikur mori përsipër funksionin e së vërtetës – sikur kjo të kish ndodhur vetëm një herë, edhe pse, në fakt, nuk ndodhi vetëm një herë. Tek e fundit, seksualiteti nuk është dhe kaq i papranueshëm. Dhe pasi e mori përsipër atë funksion, e mbajti.

Se për çfarë është fjala, këtë mund ta marrim me mend, së paku psikanalisti mundet; dhe ai vetë është dëshmitar i këtij fakti, sa herë që flet për diçka serioze, jo për rezultatet e tij terapeutike. Çfarë mund të rroket mendërisht, pra, është fakti që seksualiteti ia hap një vrimë së vërtetës.

Seksualiteti është pikërisht lëmi ku, nëse mund të shprehem kështu, askush nuk di çfarë të bëjë me të vërtetën. Dhe kur vjen puna për marrëdhëniet seksuale, çështja se çfarë jemi duke bërë tamam të del gjithnjë përpara – jo aq kur i themi dikujt 'Të dua', sepse të gjithë e dimë se vetëm kastravecët e thonë këtë, por kur kemi marrëdhënie seksuale me dikë, kur kjo të shpie diku, kur merr formën e çfarë quajmë akt.

Një akt nuk është thjesht diçka që të ndodh ty vetvetiu, një shkarkim lëvizor, siç e thotë me ngut dhe pak si tepër shpesh teoria analitike – madje edhe sikur, me ndihmën e një numri të caktuar artificesh, ndërmjetësimesh të ndryshme, ose edhe falë ravijëzimit të një farë promiskuiteti, ne ia arrijmë ta shndërrojmë aktin seksual në diçka që, siç na thonë, nuk



ka më shumë rëndësi se të pish një gotë ujë të ftohtë.

Kjo nuk është e vërtetë, siç mund ta kuptoni lehtë. Sepse çështja këtu është që ti ndonjëherë pi një gotë ujë dhe pastaj të zë barku. Nuk është kaq e thjeshtë, për arsye që lidhen me thelbin e gjësë. Brenda kësaj marrëdhënieje, ti pyet veten, me fjalë të tjera, nëse je vërtet burrë, po të jesh burrë, ose nëse je vërtet grua, po të jesh grua. Këtë pyetje nuk është se ia bën vetes vetëm partneri yt ose partnerja jote; edhe ti ia bën vetes gjithashtu, të gjithë e bëjnë, dhe kjo ka rëndësi, ka rëndësi të menjëhershme.

Prandaj, kur unë flas për një vrimë në të vërtetën, kjo nuk është, natyrisht, ndonjë metaforë trashanike. Nuk është si vrima që ke në xhaketë, por aspekti negativ që shfaqet në gjithçka që lidhet me seksualitetin, dhe pikërisht me paaftësinë e tij për t'u vërtetuar. Ja, me këtë merret psikanaliza.

Një gjë që e nisim kështu, nuk e lëmë dot me kaq. Po të nisim me një çështje si kjo, një çështje që është vërtet me vend dhe që të gjithë ia kërkojnë përgjigjen, mund ta marrim me mend edhe se, çfarë Freud-i quante seksualitet, merr një kuptim të ri që në krye.

Termat e Freud-it kthehen në jetë dhe marrin një kuptim të ndryshëm. Ne madje e vërejmë këtë edhe në aspektin e tyre literal, çka është një mënyrë për të treguar se sa të përshtatshëm janë për të manipuluar temën tonë. Ideali këtu është, natyrisht, që ta shtyjmë diskutimin po aq thellë sa ç'kam filluar ta shtyj unë. Unë i kam detyruar, literalistët [*les littéraires*] që ta pranojnë, më në fund, se ti mund t'ia dalësh që të krijosh një gjuhë, kur dëshiron të shmangësh ambiguitetin ose, me fjalë të tjera, kur e redukton atë në diçka literale, ose në shkronjat e vogla të algjebrës.

Kjo na shpie drejtpërdrejt në kapitullin e dytë: origjinën e mësimit tim.

## 2

Pra, siç e shihni, është e kundërta e çfarë po thosha pak më parë.

Ju thashë se vendi i saj ishte rastësor. Pastaj, u shtyva deri te vrima për të cilën po flasim, dhe askujt nuk i pëlqen kur i del kjo përpara. Arsyeja pse unë përpiqem kaq seriozisht është se, pasi e ke nisur, nuk mund ta ndalosh si të duash.



Tani, sa për origjinën, kjo nuk ka kuptimin që mund t'ju ketë shkuar në mendje kur e dëgjuat së pari, d.m.th. kur dhe pse filloi.

Nuk po ju flas për çfarë e kanë quajtur, fisnikërisht, origjinë të mendimit tim ose edhe të praktikës sime në disertacione që kanë mbrojtur në Sorbonne ose në fakultete të tjera të arteve. Një person qëllim-mirë madje donte që unë t'ju flisja për z. Clérambault, por unë nuk do t'ju flas për të, sepse nuk është rasti.

Clérambault-i më mësoi disa gjëra. Thjesht më mësoi të shihja se çfarë kisha përpara: një të çmendur. Siç i takon një psikiatri, ai ma mësoi këtë duke ndërvendosur një teori të vogël shumë të bukur – mekanicizmin – midis meje dhe atij tjetrit, të çmendurit, që është gjëja më shqetësuese në botë, po ta mendosh mirë. Kur je psikiatër, ti gjithnjë ndërvendos diçka.

Kështu, kemi para nesh një tip që manifeston atë çfarë Clérambault e quante 'automatizëm mendor', ose, me fjalë të tjera, një tip që nuk bën dot as edhe një gjest pa e urdhëruar dikush, pa i thënë: 'Pa shih çfarë po bën, dreqi.' Sikur ti të mos jesh psikiatër, sikur thjesht të kesh një qëndrim njerëzor,

ndërsubjektiv, simpatizues, me siguri do të hidhesh përpjetë, po të vijë ndonjë dhe të të thotë diçka të tillë.

Një tip që jeton ashtu, që nuk bën dot as edhe një gjest pa thënë dikush 'Pa shih, po shtrin krahun, dreqi,' mund të habisë, por nëse ti shpall pastaj se ky është efekti i një mekanizmi diku, i diçkaje që të ngacmon rrudhat e trurit dhe, për më tepër, diçka që s'e ka parë kurrë njeri, atëherë hajde qetësohu pastaj. Clérambault-i më mësoi shumë gjëra për statusin e psikiatërve.

Unë s'e kam harruar dot çfarë më ka mësuar ai për automatizmin mendor. Shumë njerëz e kanë vërejtur këtë dukuri që atëherë, dhe e kanë përshkruar pak a shumë në të njëjtën mënyrë, por kjo nuk ia heq vlerën faktit që ti e dëgjon nga burimi vetë. Përndryshe, Clérambault-i ishte vëzhgues i mprehtë, meqë në fakt askush para tij nuk e kish vënë re natyrën e këtij automatizmi mendor. Pse? Sepse psikiatrit aso kohe e fshihnin atë edhe më mirë. Ndonjëherë ata vendosnin kaq shumë 'fakultete të arteve' mes vetes dhe të çmendurve të tyre, sa as dukurinë të mos e shihnin dot.



Edhe sot mund ta shohim më mirë, mund ta përshkruajmë halucinacionin me terma të tjerë. Mjafton të jesh vërtet psikanalist, por ata nuk janë psikanalistë. Nuk janë tamam psikanalistë në atë masë që, edhe pse janë psikanalistë, e ruajnë një distancë fisnike mes vetes dhe atyre të tjerëve, të cilët edhe prej psikanalistëve quhen të sëmurë mendorë. Por le ta lëmë me kaq.

Sa për origjinën e mësimit tim, ne nuk flasim dot për të më shumë se ç'mund të flasim për çdo çështje tjetër origjine.

Origjina e mësimit tim është fare e thjeshtë, ka qenë gjithnjë aty. Mësimi im është, në fakt, thjesht gjuha dhe absolutisht asgjë tjetër.

Për më të shumtën prej jush, kjo është ndoshta hera e parë që keni dëgjuar diçka të tillë, meqë unë besoj, vërtet, se shumë njerëz këtu ende nuk kanë hyrë në Epokën e Iluminizmit. Shumë njerëz këtu ndoshta besojnë se gjuha është superstrukturë. Mirëpo këtë as Stalini nuk e besonte. Ai e shpjegoi, shumë qartë, se po të mbështetemi në këtë premisë, punët mund të komplikohen keqas, dhe në një vend që unë do të guxoja ta përshkruaja si të

përparuar – ndoshta nuk do të kem kohë t'jua shpjegoj pse – kjo do të kishte pasoja. Tani, diçka që ndodh në universitet shumë rrallë mund të ketë pasoja, sepse universiteti është i organizuar në mënyrë të tillë që të garantojë që mendimi të mos ketë kurrë ndonjë pasojë. Mirëpo kur i hyn kësaj pune, siç ndodhi dikur në 1917 me Marr-in që deklaroi se gjuha ishte superstrukturë, mund të lësh pasoja, për shembull, të zësh të ndryshosh rusishten. Prisni pak, tha Baba Stalini, i cili e ndjeu katastrofën që kërcënohej, pështjellimin që mund të sillte kjo. 'Mos e vazhdoni më këtë muhabet. Gjuha nuk është superstrukturë,' tha Stalini, dhe në këtë pikë ai pajtohet me Heidegger-in: 'Njeriu banon në gjuhë.'

Çfarë kish parasysh Heidegger-i me këtë nuk ka të bëjë me çfarë do t'ju them unë këtu sonte, por, siç mund ta merrni me mend, më duhet të pastroj pak vendin para monumentit. 'Njeriu banon në gjuhë' ... edhe kur nxirret nga teksti i Heidegger-it, flet vetvetiu. Do të thotë se gjuha ekziston para njeriut, natyrisht. Jo vetëm njeriu lindet në gjuhë njëlloj sikurse lindet në botë; ai lindet nëpërmjet gjuhës.



Kjo e përcakton origjinën e asaj për çka po flasim. Askush para meje nuk duket t'i ketë dhënë edhe rëndësinë më të vogël faktit që, në librat e hershëm të Freud-it, librat themelorë për ëndrrat, për psikopatologjinë e jetës së përditshme, për batutat, gjejmë një faktor të përbashkët, që lidhet me praninë e kudogjendshme të fjalëve, të vrimave në ligjërim, të lojërave të fjalëve, të replikave, të ambiguiteteve. Kjo u shërben si mbështetje interpretimeve të para dhe zbulimeve përurimore në lëmin e përvojës psikanalitike dhe në lidhje me fushën e përcaktuar prej kësaj përvoje.

Merreni librin për ëndrrat, që u botua i pari, dhe hapeni në një faqe çfarëdo, dhe do të shihni se aty nuk flitet për gjë tjetër, përveçse për gjëra që kanë të bëjnë me fjalët. Në çfarë thotë Freud-i për to, do të gjeni ligjet strukturore të De Saussure-it, që ky ia bëri të njohura botës mbarë. Ai nuk ishte i pari që i zbuloi, por pati meritën që i përcolli, duke i ofruar një bazë gjithçkaje solide që po bëhet sot në fushën e gjuhësisë.

Te Freud-i, ëndrra nuk është një natyrë që ëndërron, një arketip që lëviz, një matricë

për botën, një vegim hyjnor, ose zemra e shpirtit. Freud-i e përshkruan ëndrrën si një lloj nyje, si një rrjet asociativ formash verbale të analizuara që kryqëzohen si të tilla, jo për shkak të kuptimit të tyre, por falë një lloj homonimie. Kur ti mbërrin te një fjalë e vetme, te kryqëzimi i tri ideve që kanë të bëjnë me subjektin, atëherë e vëren se është pikërisht ajo fjalë gjëja më e rëndësishme. Kur ti e gjen fjalën që përqendron, rreth vetes, numrin më të madh të fijeve në micel, atëherë ke gjetur qendrën e fshehtë të rëndesës, të dëshirës përkatëse. Për këtë e kisha fjalën pak më parë, për pikën nyjore ku ligjëratës i hapet një vrimë.

Po ia lejoj vetes këtë prozopope vetëm për t'ua bërë më të lehtë konceptin atyre që nuk e kanë dëgjuar ndonjëherë më parë.

Kur unë e formuloj mendimin tim duke thënë se e pavetëdijshmja strukturohet si gjuhë, jam duke u përpjekur t'ia rikthej funksionin e mirëfilltë gjithçkaje që strukturohet nën emrin e Freud-it dhe që, si e tillë, na lejon të shohim hapin e parë që po ndërmarrim.

E vërteta ekziston pikërisht ngaqë ekziston gjuha, siç mund të bindet kushdo.



Pse duhet që diçka që shfaqet si pulsim i gjallë dhe që mund të ndodhë në një nivel aq vegjetativ sa të duam, ose në nivelin më të përpunuar si gjestualitet, të jetë më e vërtetë se gjithçka tjetër? Përmasa e së vërtetës nuk është askund, sa kohë që jemi thjesht duke u marrë me biologji. Edhe sikur ta pranojmë atë përmasë thjesht për t'i hedhur hi syve një kundërshtari, çfarë do të shtonte aspekti biologjik? Është po aq e vërtetë sa gjithçka tjetër, pikërisht ngaqë ne synojmë të arrijmë një rezultat real, ose ta vëmë tjetrin me shpatulla për muri. E vërteta fillon të përcaktohet vetëm që nga momenti kur ekziston gjuha. Sikur e pavetëdijshmja të mos ishte gjuhë, ajo çka do ta quanim të pavetëdijshme në kuptimin freudian nuk do të kish më asnjë privilegj, do të humbte çdo interes.

Së pari, ngaqë, sikur e pavetëdijshmja të mos ishte gjuhë, ajo nuk do të ekzistonte fare, në kuptimin freudian. Po e pavetëdijshmja? E pavetëdijshmja si e tillë, pa dyshim do të ekzistonte. Mirë pra, le të flasim për të. Edhe kjo tryezë e pavetëdijshme është.

Këto gjëra janë harruar pothuajse fare nga perspektiva e ashtuquajtur evolucioniste. Nga

kjo perspektivë, disave u duket normale të thonë se faza minerale çon natyrshëm te një pikë më e lartë, ku fillon të shfaqet vetëdija, me demek vetëdija u përvijua në kundërvënie me çka i paraprinte. Nëse gjithçka na mbetet të bëjmë, është ta mendojmë vetëdijen në formën e funksionit njohës që ua bën të mundur qenieve shumë të zhvilluara që të pasqyrojnë diçka prej botës, atëherë çfarë avantazhi do të kishte kjo vetëdije, në raport me të gjitha funksionet e tjera të krijesave biologjike si të tilla? Idealistët, për të cilët nuk kanë lënë gjë pa thënë, e kanë shtruar këtë çështje me qartësi të madhe.

Nuk është edhe se na mungonin termat e duhur për krahasimin. Ne kemi një shkencë të organizuar mbi një bazë që nuk është aspak ajo që ju kujtoni se është. Nuk ka fare të bëjë me gjenezën. Ne nuk e krijuam shkencën duke u sintonizuar me pulsimin e natyrës. Jo. Ne luajtëm pak me shkronja dhe figura të vogla dhe i përdorëm për të sendërgjuar makina që punojnë mirë, që fluturojnë, që shkojnë anembanë botës, që udhëtojnë në distanca të largëta. Kjo nuk ka absolutisht asnjë lidhje me



çfarë është ëndërruar sipas regjistrit të njohjes. Kjo gjë ka organizimin e vet. Që, më në fund, shfaqet si thelbi i saj i mirëfilltë, d.m.th. llojet e ndryshme të kompjuterëve, elektronikë ose jo. Ja, ky është organizimi i shkencës.

Ky nuk funksionon vetvetiu, natyrisht, por unë mund t'ju provoj se, hë për hë dhe derisa të ndryshojnë rrethanat, e kemi të pamundur të ndërtojmë një urë që të bashkojë format shumë të evoluara të organeve të një organizmi të gjallë me këtë organizim të shkencës.

Dhe megjithatë, nuk është se këto nuk kanë lidhje mes tyre. Ka linja që i bashkojnë, tuba dhe fije. Por një tru njerëzor është shumë më i pasur se çdo lloj makine që kemi arritur të ndërtojmë deri më tash. Si shpjegohet që nuk mund të pyesim, pra, se pse nuk funksionon në të njëjtën mënyrë?

Pse nuk mund të kryejmë tre miliardë operacione, mbledhje dhe shumëzime, dhe veprime të tjera standard për njëzet sekonda, siç bën makina; në një kohë që brenda trurit tonë lëvizin kaq shumë gjëra? Çuditërisht, truri punon ndonjëherë ashtu, për një kohë të shkurtër. Me sa dimë, truri i një të

prapambeturi mendor ashtu punon. Njihet mirë dukuria e *débils calculateurs*, që janë në gjendje të llogarisin si të ishin makina.

Kjo na sugjeron se gjithçka që lidhet me mënyrën si mendojmë është, ndoshta, rezultat i një numri të caktuar efektesh gjuhësore, dhe se këto janë të tilla që ne mund të operojmë me to. Dua të them, që ne mund të ndërtojmë makina që janë, njëfarësoj, të barasvlershme me to, por në masë shumë të kufizuar në krahasim me ç'mund të prisnim nga një prodhueshmëri e ngjashme, sikur të kishim të bënim vërtet me një tru që të funksiononte në të njëjtën mënyrë.

Nuk po i them të gjitha këto për të krijuar ndonjë premisë të qëndrueshme, por vetëm që t'ju shtie në mendje nevojën për të qenë të kujdesshëm, sidomos sa herë që funksioni mund të duket se vepron falë çfarë e quajnë 'paralelizëm'. Jo aq për të hedhur poshtë paralelizmin e njohur psiko-fizik, të cilin e kanë provuar tashmë, që prej shumë kohësh, se është profkë; sesa për të sugjeruar se ndarja nuk duhet bërë midis fizikes dhe psikikes, por midis psikikes dhe logjikes.



Tani që arritëm këtu, mund të fillojmë të krijojmë një ide se çfarë kam parasysh kur them se është e domosdoshme të marrim parasysh si janë punët me gjuhën, nëse dëshirojmë të fillojmë të kuptojmë diçka për funksionin e së pavetëdijshmes.

Në fakt, mund të jetë e vërtetë se e pavetëdijshmja nuk funksionon sipas një logjike të njëjtë me të mendimit të vetëdijshëm. Me ç'rast, do të duhet të pyesim: po sipas cilës logjikë atëherë?

Ajo gjithnjë funksionon logjikisht, dhe këtu nuk është fjala për ndonjë paralogjikë. Jo, është një logjikë më e përkulshme, më e dobët, siç thonë logjicienët. 'Më e dobët' tregon praninë ose mungesën e disa korrelacioneve bazë, mbi të cilat mbështetet toleranca e asaj logjike. Një logjikë më e dobët nuk është më pak interesante se një logjikë më e fortë, madje, në fakt, është shumë më interesante, sepse është shumë më e vështirë për ta mbajtur; dhe ajo, gjithsesi, e bën punën. Kjo logjikë mund të jetë me interes, madje ne, si psikanalistë, mund të fillojmë të interesohemi për të dhe ta bëjmë objekt eksplicit të hulumtimit tonë, me kusht që të ketë psikanalistë rrotull.

Ju ftoj të mendoni për të në vija shumë të trasha. Aparati gjuhësor gjendet diku në tru, si merimangë. Ushtron kontroll.

Kjo mund t'ju habitë dhe ju mund të pyesni: "Po mirë, çfarë po thoni kështu, po gjuha_nga vjen?" Unë nuk kam asnjë ide për këtë. Nuk kam asnjë detyrim që të di gjithçka. Dhe veç kësaj, as ju nuk dini gjë për këtë.

Mos bëni gabim të mendoni se gjuhën e ka krijuar njeriu. Ju nuk jeni të sigurt për këtë, nuk keni asnjë provë, dhe nuk keni parë ndonjë kafshë njerëzore të bëhet *Homo sapiens* para syve tuaj. Kushdo që është *Homo sapiens*, e ka edhe gjuhën tashmë. Kur nisën të merren dijetarët me këtë punë dhe të shohin si e zgjidhte atë gjuhësia, sidomos një farë Helmholtz, ata refuzuan ta preknin çështjen e origjinës. Dhe ky ishte një vendim i mençur. Nuk do të thotë se e kemi përgjithmonë të ndaluar të merremi me këtë çështje, por se është mirë të mos merremi me përralla, dhe kur vjen puna për origjinën, përrallat nuk i shmang dot.

Kjo nuk do të thotë se nuk ekzistojnë stiva të tëra librash të vyer, që të japin ide tejet



zbavitëse. Rousseau-i shkroi për këtë, dhe disa prej miqve të mi të rinj të brezit të École Normale, të cilët janë aq të mirë sa të më dëgjojnë ç'kam për t'u thënë herë pas here, kanë botuar veprën e tij *Sprovë për origjinën e gjuhëve*. Libër shumë i këndshëm, jua rekomandoj ta lexoni.

Por ju duhet të tregoni kujdes për gjithçka që ka të bëjë me psikologjinë. Pasi të krijoni një ide për natyrën e disociacionit që u mundova t'jua përcjell sonte, ndoshta do ta shihni edhe kotësinë e psikologjisë së fëmijës, të Piaget-it.

Po t'i bëni një fëmije pyetje të bazuara në një aparat logjik, sidomos nëse ju vetë jeni logjicien – dhe Piaget-i ishte logjicien i zoti – atëherë nuk ka gjë për t'u habitur që do ta gjeni këtë aparat logjik edhe te fëmija që po merrni në pyetje. Do ta gjeni aty, në momentin kur ky fillon ta kafshojë karremin që i keni hedhur, mirëpo të deduktoni, që këtej, se kategoritë logjike përftohen gjatë zhvillimit të fëmijës, kjo është një *petitio principii* e kulluar. Ju i bëni fëmijës pyetje në regjistrin logjik, dhe fëmija ju përgjigjet në regjistrin logjik. Por mos mendoni se fëmijët futen në fushën e

gjuhës në atë mënyrë, në çdo nivel. Një gjë është e sigurt – që atyre u duhet kohë.

Një zotëri, që nuk ishte psikanalist aspak, ia vuri këtë re Piaget-it. Ky zotëri ishte Vigotski, nga Shën Petersburgu. U mbijetoi tallazeve të revolucionit për ca vjet, mirëpo vuante nga tuberkulozi dhe u nda prej nesh para se ta përfundonte veprën e tij. Ai vuri re se, çuditërisht, futja e fëmijës në aparatin logjik nuk duhet parë si rezultat i ndonjë zhvillimi të brendshëm psikik, por përkundrazi, duhet parë si diçka e ngjashme me mënyrën si mësojnë fëmijët të luajnë, nëse mund të shprehemi kështu.

Ai vuri re, për shembull, se fëmijët e rrokin nocionin e konceptit pasi arrijnë pubertetin. Tani, pse ndodh kështu? Si kategori, pubertеti është i tjetërllojshëm nga idetë e çuditshme rreth mënyrës si fillojnë të funksionojnë cirkumvolucionet cerebrale. Vigotski e pa këtë me qartësi të madhe, në praktikën e vet.

Nuk mund ta lë pa trajtuar, këtu, funksionin e subjektit, pavarësisht se ç'më kanë thënë më parë. E kanë ekzagjeruar. Personalisht, mendoj se po më dëgjoni si duhet. Jeni shumë të mirë,



por edhe më shumë se kaq, sepse mirësia vetëm nuk mjafton, që të më dëgjoni si duhet.

Prandaj mund t'ia lejoj vetes të shtyhem më tej dhe t'ju them ca gjëra pak më të vështira.

## 3

Pse e përmenda funksionin e subjektit si diçka të ndryshme nga gjithçka që ka të bëjë me psikizmin?

Nuk mund t'ju jap ndonjë shpjegim teorik, por mund t'ju tregoj sesi kjo lidhet me funksionin e subjektit në gjuhë, i cili është i dyfishtë si funksion.

Kemi subjektin e thënies (*énoncé*). Ky subjekt është fare i lehtë për t'u identifikuar. *Unë* do të thotë personi që po flet në momentin kur unë them *unë*. Por subjekti nuk është gjithnjë subjekt i thënies, sepse jo të gjitha thëniet përmbajnë *unë*. Edhe kur nuk ka ndonjë *unë*, edhe kur themi "po bie shi", ka një subjekt të thëniezimit [fr. *énonciation*], dhe ky subjekt ekziston edhe kur nuk mund të rroket dot më në fjali.

Kjo qasje na lejon të shpjegojmë shumëçka. Subjekti që na intereson këtu, subjekti jo në atë

masë që përfton ligjëratë, por në atë masë që përftohet, ose edhe kapet në çark nga ligjërata, është subjekti i thëniezimit.

Kjo më lejon të sjell një formulë të cilën dua t'ua prezantoj si një nga më kryesoret. Është një përkufizim i çka e quajmë 'element' në gjuhë. Gjithnjë ashtu është quajtur, 'element', madje edhe në greqishte. Stoikët e quanin 'shënjuesi'. Çfarë e dallon këtë nga shenja është se 'shënjuesi është ajo çka përfaqëson subjektin kundrejt një shënjuesi tjetër', jo për një subjekt tjetër.

Çfarë kam ndër mend të bëj sonte është që t'ju ngjall pak interes. Nuk besoj se mund të bëj më shumë se sa t'jua rras në dorë dhe t'ju them 'Provoni ta vini në punë.' Veç kësaj, ca sugjerime do t'i keni marrë herë pas here, sepse unë kam nxënës që, herë pas here, e tregojnë se si funksionon kjo.

Çfarë ka rëndësi, në këtë mes, është se ajo lyp një prezantim topologjik, të një farë rrafshi, të cilën le ta quajmë 'Rrafshi T'. Ndonjëherë e quajnë edhe 'Tjetri', sidomos ata që e dinë se për çfarë e kam fjalën. Për t'u orientuar pak në lëmin e funksionimit të subjektit, ky Tjetër



duhet përkufizuar si selia e ligjërimit (*parole*). Jo si vendi ku shqiptohet fjala, por vendi ku merr vlerën e ligjërimit ose, me fjalë të tjera, ku përuron përmasën e së vërtetës. Është absolutisht e domosdoshme, për funksionimin e çka po trajtojmë.

Menjëherë do të vërejmë se asgjë nga këto nuk mund të ndodhë vetvetiu, për lloj-lloj arsyesh. Kryesorja këtu është se Tjetri, për të cilin po ju flas, përfaqësohet nga një qenie e gjallë reale, për të cilën mund të doni të më bëni ndonjë pyetje, edhe pse nuk jeni të detyruar. Mjafton t'ju them se Tjetri është ai të cilit i thoni 'Dashtë Zoti që...', ose diçka të ngjashme, duke përdorur mënyrën dëshirore, ose mënyrën lidhore. Tani, kjo seli e së vërtetës merr një kuptim shumë të ndryshëm. Edhe vetëm thënia që ju përcolla mjafton për t'ju bërë ta ndieni këtë.

Kjo na shpie te një e vërtetë tepër e veçantë: e vërteta e dëshirës. Logjika e dëshirës, një logjikë që nuk është në mënyrën dëftore, nuk është shtyrë ndonjëherë kaq larg.

Disa kanë filluar të lëvrojnë çfarë e quajnë 'logjikë modale', por nuk kanë qosur ndonjë

gjë të madhe, ndoshta sepse nuk e kanë kuptuar se regjistri i dëshirës duhet ndërtuar patjetër në nivelin e Rrafshit T, me fjalë të tjera, që dëshira është gjithnjë pasojë e nyjëtimit të gjuhës në nivelin e Tjetrit.

Dëshira e njeriut, thashë një herë, kur më duhej të shpjegohesha – pse të mos them 'e njeriut', edhe pse kjo nuk është fjala e duhur – dëshira, me një fjalë, është gjithnjë dëshira e Tjetrit. Çka do të thotë, në thelb, se ne gjithnjë ia kërkojmë Tjetrit dëshirën e vet.

Kjo që po ju them është e lehtë për t'u rrokur, dhe aspak e pakuptueshme. Kur të ikni që këtej, do ta kuptoni se është e vërtetë. Ju thjesht duhet të mendoni për të dhe ta formuloni si të tillë. Dhe veç kësaj, këto formula janë gjithnjë shumë praktike, sepse mund të kthehen përmbys.

Një subjekt i caktuar, dëshira e të cilit është që Tjetri t'i kërkojë diçka – fare e thjeshtë, ne e kthejmë përmbys – ja, ky është përkufizimi i neurotikut. E shihni sa praktike është kjo, nëse keni nevojë të orientoheni? I vetmi problem është se duhet ta shihni nga shumë, shumë afër. Dhe kjo kërkon kohë, s'bëhet për një ditë.



Mund të shkoni më tej dhe menjëherë do të kuptoni pse fetarët i kanë krahasuar me neurotikët.

Mirëpo fetari nuk është aspak neurotik. Ai është fetari. Vetëm se duket si neurotik, sepse edhe ai i organizon gjërat rreth çka është, në fakt, dëshirë e Tjetrit. I vetmi dallim këtu është se, meqë ky Tjetër në këtë rast nuk ekziston, sepse është Zoti, kemi nevojë për provë. Prandaj pretendojmë se Tjetri po na kërkon diçka. Viktima, për shembull. Prandaj kjo, shkallë-shkallë, vjen dhe ngatërrohet me qëndrimin e neurotikut, veçanërisht të neurotikut obsesiv. Nis t'u ngjajë jashtëzakonisht shumë të gjitha teknikave të përdorura në ceremonitë e sakrificës.

Kjo është edhe mënyra që kam zgjedhur për t'ju shpjeguar se këto gjëra janë të lehta për t'u kuptuar dhe se ato jo vetëm nuk bien në kundërshtim me çfarë ka thënë Freud-i, por e bëjnë madje edhe më të lexueshëm.

Këto mund t'i nxjerrim edhe nga një lexim i thjeshtë i Freud-it, sa kohë që e kemi prerë mendjen të mos e lexojmë me syzet krejt opake që mbajnë zakonisht psikanalistët, për

ta mbajtur shpirtin në paqe. Ju thjesht duhet t'i çoni gjërat pak më tutje, për të parë se jemi duke u kuturisur në një truall të minuar, ku çështjet duan rishtruar disi.

Fakti që ne mund të shohim një lidhje midis neurotikut dhe fetarit nuk përbën arsye për të nxjerrë menjëherë ndonjë përfundim të nxituar, duke i trajtuar së bashku. Ka një nuancë aty, të cilën duhet të jeni në gjendje ta dalloni dhe të merrni vesh pse është e vërtetë, deri në ç'masë dhe pse jo krejt e vërtetë.

Kjo s'do të thotë se po i kundërvihemi Freud-it, por vetëm se po e përdorim. Atëherë do ta rrokim kuptimin e çfarë na dukej aq opake në fjalën e tij. I shkreti Freud, i ishte përveshur punës si arkeolog, duke gërmuar e duke hapur llagëme e duke mbledhur objekte. Ndoshta nuk ishte shumë i sigurt se çfarë duhet bënte: a duhej t'i linte gjërat *in situ*, apo t'i nxirrte që andej dhe t'i çonte në raftin e vet? Kjo tregon se ka diçka të vërtetë në debatin për një të vërtetë të llojit të ri, që filloi me Freud-in.

Tani le të kthehemi te dëshira e Tjetrit.

Nëse jeni marrë ndonjëherë seriozisht me përftimin e dëshirës, d.m.th., në bazë



të gjuhës, duke e vënë në marrëdhënie me bazën e saj gjuhësore themelore, që është metonimia, siç i thonë, do të mund të bëni përpara shumë më mirë, në fushën që do të eksplorojmë: psikanalizën. Madje mund edhe të vini re rrënjët e mirëfillta të diçkaje që, në teorinë psikanalitike, mbetet ende kaq opake, kaq e pagdhendur dhe kaq e penguar.

Nëse dëshira përftohet në fushën e Tjetrit, dhe nëse "dëshira e njeriut është dëshira e Tjetrit", atëherë ndodh që njeriut t'i mungojë dëshira e tij. Tani, ju keni aq përvojë sa të mos i shihni gjërat me aq ngut sa më parë, dhe të mos mjaftoheni me shpjegime anekdotike të menjëhershme. Kur dëshira e njeriut duhet nxjerrë nga fusha e Tjetrit për t'u bërë dëshira ime, ndodh diçka e çuditshme. Tani që është radha ime për të dëshiruar, unë vë re se qenkam kastruar.

Ky është edhe kompleksi i kastrimit. Do të thotë se diçka ndodh në shënjesë [fr. *signifiance*], një lloj humbjeje që kërkon se, kur njeriu futet në fushën e dëshirës së vet si dëshirë seksuale, ai mund ta bëjë këtë vetëm nëpërmjet një mediumi në trajtë simboli që

përfaqëson humbjen e një organi në atë masë që merr mbi vete, në ato rrethana, një funksion shënjues, funksionin e objektit të humbur.

Do të më thoni se jam duke parashtruar diçka që nuk është se ndihmon për ta kthjelluar konceptin. Por unë nuk po kërkoj kthjellim; unë po kërkoj, para së gjithash, të mos largohem nga çfarë gjejmë në përvojat tona dhe, nëse kjo nuk është e kthjellët, s'është faji im.

Para së gjithash, duhet të pranojmë kastrimin. Ne nuk jemi mësuar ta bëjmë këtë, çka e vështirëson kthjellimin. Prandaj sajojmë gjithfarë historish fantastike, përfshi këtu edhe histori për kërcënimet që na kanë bërë prindërit, të cilëve u mbetkësh faji. Të thuash se mjaftonte që prindërit të thoshin diçka të tillë, që të përftohej një strukturë kaq themelore dhe kaq universale, sa kompleksi i kastrimit.

Kemi arritur një pikë ku edhe gratë po shpikin një të tillë për veten, po shpikin një fallus të rivendikuar, thjesht në mënyrë që pastaj ta konsiderojnë veten si të kastruara, që është pikërisht çfarë ato nuk janë, të shkretat, sa kohë që bëhet fjalë për organin – penisin



– meqë ato nuk kanë të tillë. Pastaj, as që ka nevojë të na thonë se e kanë një të vockël fare, kjo nuk vlen më për asgjë.

Po edhe në qoftë ashtu, do t'ju them diçka që do t'ju qetësojë, duke ju ndihmuar të kuptoni më mirë.

Arsyeja pse ekziston kastrimi është, ndoshta, fare e thjeshtë: dëshira – sa herë që është vërtet fjala për dëshirën tonë – nuk mund të zotërohet, nuk mund të jetë diçka që e kemi, nuk mund të jetë një organ që ne mund ta kontrollojmë. Nuk mund të jetë edhe qenie, edhe pasje. Kështu, organi shërben, ndoshta, për diçka që funksionon në rrafshin e dëshirës. Është objekti i humbur, sepse ai vjen në vend të subjektit në trajtën e dëshirës. Ky do të ishte sugjerimi im.

Në këtë pikë, mund të qetësoheni. Sidomos, mos mendoni se ka ndonjë gjë të guximshme këtu. Puna është që të përpiqemi të formalizojmë si duhet çfarë nuk është asgjë më tepër sesa një përvojë me të cilën kemi të bëjmë përditë.

Ne kemi studentë që vijnë të na tregojnë histori për pacientët e tyre, dhe që më në fund

e vënë re jo vetëm se ne mund t'i kuptojmë pacientët me këtë gjuhë të Lacan-it po aq lehtë sa edhe me gjuhën e adoptuar dhe popullarizuar nga institucione të themeluara mbi një bazë tjetër; por edhe se mund t'i kuptojmë më mirë.

Pacientët ndonjëherë thonë gjëra shumë të zgjuara, dhe në këto raste ata flasin ligjëratën e vetë Lacan-it. Vetëm se, sikur psikanalistët të mos e kishin dëgjuar Lacan-in më parë, as nuk do ta kishin dëgjuar pacientin dhe do të kishin thënë: 'Thjesht një tjetër i sëmurë mendor, që flet marrëzira.'

Tamam. Tani le t'i kthehemi fundit.

4

Të flasim tani për qëllimin e mësimit tim, për *telos*-in, ose pse e bëj.[1]

Qëllimi i mësimit tim është, natyrisht, të përgatitë psikanalistët që të ngrihen në nivelin

[1] Këtu frëngjishtja ka një lojë fjalësh me fjalën *fin*, e cila ka kuptimin 'fund', por edhe 'qëllim, synim.' Lacan-i shpjegon se, me *fin*, nuk ka parasysh fundin e botës, por *telos*-in e mësimit të vet.



e funksionit të subjektit, sepse vetëm nga ky këndvështrim mund të shohim vërtet se me çfarë merret psikanaliza.

'Psikanalistë që të ngrihen në lartësinë e subjektit' mund të mos tingëllojë dhe aq e qartë për ju, por ashtu është e vërteta. Do të përpiqem t'ju skicoj se çfarë mund të deduktojmë nga kjo, nga teoria e psikanalizës didaktike.

Për psikanalistët, nuk do të ishte shërvitje e keqe që të bënin pak matematikë. Në matematikë subjekti është fluid dhe i kulluar, dhe nuk ka ngecur, as është kapur gjëkundi. Kjo do t'i ndihmonte dhe do të shihnin se ka raste kur asgjë nuk po qarkullon më, pikërisht ngaqë, siç e pamë pak më lart, Tjetri duket se është i ndarë midis selisë së të vërtetës dhe selisë së dëshirës së Tjetrit. E njëjta gjë ndodh me subjektin.

Një subjekt në bazë të gjuhës; ky është subjekti që mund ta purifikojmë në mënyrë kaq elegante, me anë të logjikës matematike. Vetëm se ka ende gjithnjë diçka për t'u cituar, diçka që ekzistonte që më parë. Subjekti farkëtohet nga një varg i caktuar nyjëtimesh që

kanë ndodhur, dhe bie nga zinxhiri shënjues njëlloj sikurse bie fruti i pjekur nga dega. Sapo ai vjen në botë, ai bie nga një zinxhir shënjues, që mund të jetë fare mirë i ndërlikuar, ose të paktën i nyjëtuar, dhe ajo çfarë ne quajmë dëshirë e prindërve të tij i nënvendoset të njëjtit zinxhir. Do të ishte e vështirë ta shpërfillje këtë kur është fjala për lindjen e tij, edhe e sidomos kur dëshira ishte, pikërisht, që ai të mos lindte.

Më e pakta që mund të kërkojmë, është që psikanalistët ta kuptojnë se janë poetë. Kjo tingëllon argëtuese, tepër argëtuese.

Do të përdor tani disa shënime që shkrova në tren, për t'ju ndihmuar. Aty kishte edhe një kopje të *France-Soir*, dhe unë i hodha një sy.

Flitej për Claudine-n, atë francezen e bukur, që e mbytën apo e vranë me thikë, nuk e di, por gjithsesi, ishte edhe ky amerikani që u zhduk me të shpejtë dhe tani e kanë futur në një çmendinë, të shohim sa do ta ndihmojë kjo.

Le të mendojmë për këtë. Ai është në çmendinë, dhe një psikanalist shkon ta takojë atje, sepse amerikani është nga familje shumë e mirë. Edhe çfarë zbulojmë? Zbulojmë LSD.



Me sa duket, ky ishte i droguar, kur ndodhi krimi.

LSD, por edhe kjo, edhe LSD-ja nuk mund t'i shpërbëjë zinxhirët shënjues. Ose, të paktën, le të shpresojmë se do të gjejmë diçka të pranueshme. Ndeshim në çfarë njihet si impuls vrastar, dhe vëmë re se ai është i nyjëtuar për bukuri me një numër të caktuar zinxhirësh shënjues, të cilët kishin luajtur rol vendimtar në një moment ose në një tjetër të së shkuarës së atij tipit.

Do të thonë: muhabete psikanalistësh. Pse të mos themi se ai e vrau vajzën, shkoqur fare? Mirëpo është e vërtetë edhe se ka disa shkaqe për këtë, diku në nivelin e zinxhirit shënjues. Kështu thotë psikanalisti dhe, për çudi, ne i besojmë.

Më falni, duhet të thosha: i besojnë. Nëse ne nuk e besojmë, do të na shohin shtrembër, do të na konsiderojnë si prapa botës. Prandaj duhet të kuptojmë se çfarë do të thotë që ta besosh psikanalistin. Natyrisht, nuk është se po shpresoj shumë në shpirtmirësinë e gjykatësve anglezë. Kjo duhet së paku t'i nxitë psikanalistët ta shohin me sy kritik

çfarë të ngjashme ndodh gjatë, për shembull, transferencës.

Psikanalisti thotë se transferenca pasqyron diçka që ka ndodhur në të shkuarën. Ja, këtë thotë. Rregullat e lojës thonë se duhet t'i besojmë. Po pse u dashka ta besojmë, në fund të fundit? Pse të mos ketë vlerën e vet, çfarë po ndodh në transferencë tani? Ndoshta duhet të gjejmë një regjim tjetër reference, për të përligjur preferencën ndaj pikëvështrimit të psikanalistit, kur është puna për të kuptuar se çfarë ka ndodhur vërtet.

Kjo ide nuk është se më lindi mua. Një psikanalist amerikan – se ata nuk janë të gjithë budallenj, xhanëm – ka komentuar saktësisht kështu, në një numër relativisht të vonë të *Journal officiel de la psychanalyse.*

Dua ta mbyll me të gjallët, siç thonë. Prandaj po sjell një shembull. "Sikur ta kisha ditur," më tha një herë një pacient imi, "do ta kisha lagur dyshekun më shumë se dy herë në javë."

Po jua kursej hollësitë, se çfarë e bëri të thoshte ashtu. Kjo erdhi pas një vargu përsiatjesh për privacione të ndryshme dhe pasi



ai kish shlyer disa nga borxhet që besonte se i kishte. Tani ndihej i çliruar dhe, çuditërisht, i vinte keq që nuk e kish bërë këtë më parë.

Këtu ka një diçka që më tërheq veçanërisht vëmendjen: psikanalisti nuk e kupton mirë pozicionin vendimtar që ka, duke nyjëtuar, *nachträglich*, siç shprehet Freud-i, një goditje prapavepruese e cila përcakton vërtetësinë e çfarë kishte ndodhur më parë. Ai vërtet nuk e di se çfarë është duke bërë, kur po bën ashtu.

*Après coup* [shqip: *goditje prapavepruese*] ... këtë fjalë e gjen në faqet e para të një fjalori që doli në shtyp jo shumë kohë më parë. Nuk kam nevojë t'ju them se askush nuk do ta kishte përfshirë këtë 'goditje prapavepruese' në një fjalor termash të Freud-it, sikur të mos e kisha futur unë si koncept, në mësimet e mia. Askush para meje nuk e kish vënë re rëndësinë e kësaj *nachträglich*, ndonëse atë e gjen në çdo faqe të Freud-it. Dhe megjithatë, ka rëndësi të madhe që ta trajtojmë veçmas 'goditjen prapavepruese' në këtë rast.

Asnjë psikanalisti nuk i kish shkuar mendja për këtë, në kuptimin që të shkruante për të, edhe pse kjo ka drejtpërdrejt lidhje me çfarë

ai bën, si psikanalist. Kur ndonjëri na thotë 'Zot i madh që je në qiell, pse nuk e laga dyshekun më shpesh se dy herë në javë?', nëse ju dini si të dëgjoni, kjo do të thotë se duhet marrë parasysh fakti i lagies së dyshekut dy herë në javë, së bashku me shifrën 2 e cila i bashkëlidhet simptomës enuretike.

Ndoshta të dish si të përdorësh çfarë nuk është asgjë më tepër sesa efekt i koherencës së brendshme të mendimit është më së e mjaftueshme. Kur mendimi nuk është tepër empirik, ai nuk konsiston në atë që të rrish me sytë të zgurdulluar dhe të presësh që të të vijë frymëzimi prej fakteve.

Dhe veç kësaj, si mund të themi deri edhe që po merremi me fakte, me fakte të thjeshta dhe të kulluara, në një situatë aq të nyjëtuar, aq ndërhyrëse, dhe aq artificiale sa psikanaliza? Fakti që psikanalisti nuk lëviz kurrë nga vendi dhe rri pa folur treçerekun e kohës, ose 99.9% të kohës, nuk do të thotë se kjo përfaqëson ndonjë përvojë vëzhgimi. Është një përvojë në të cilin psikanalisti është përfshirë, dhe asnjë psikanalist nuk do të guxonte kurrë ta mohonte këtë. Vetëm se ti duhet ta dish se



çfarë po ndodh. Në këtë fushë, më shumë se kudo gjetiu, jemi të detyruar të pranojmë se mekanizmi real prapa një strukture shkencore është logjika e saj, jo ana e saj empirike.

Pasi ta kuptojmë këtë, ndoshta mund të fillojmë të marrim vesh diçka. Dhe ndoshta psikanalisti do të ndihej edhe më i kënaqur me veten, sikur të ishte më shumë se sa thjesht psikiatër.

Në fakt, nuk ka arsye pse duhet ta mbajmë *d*-në e vogël të famshme të T-së – dëshirën e Tjetrit – të kufizuar në fushën e praktikës analitike vetëm. Edhe pse vetëdija kolektive nuk ekziston, ne ndoshta mund të vërejmë se funksioni i dëshirës së Tjetrit është krejt thelbësor për t'u marrë parasysh, në raport me organizimin e shoqërive, sidomos ditët e sotme.

Ky rezultat buron nga përftimi i çfarë quhet zakonisht komunizëm, d.m.th. i një dëshire të Tjetrit (për Tjetrin) të bazuar në drejtësi, në kuptimin rishpërndarës të fjalës. Mund të dallojmë këtu më shumë se një bashkëlidhje, me subjektin e shkencës nga njëra anë, dhe me çfarë ndodh në nivelin e marrëdhënies me të

vërtetën, në anën tjetër. A nuk do të ishte me interes të përpiqeshim të gjenim bashkëlidhjen midis vendimit për ta vënë dëshirën e Tjetrit në krye të një regjimi dhe faktit se rezultat i kësaj është mbrojtja kokëfortë e një numri në rritje gënjeshtrash të kulluara?

Nuk dua t'ju krijoj idenë se vërejtjet e mia drejtohen kundër kuqalashëve. Nuk kisha fare parasysh këtë. Madje do t'ju jap një gjëzë tjetër. A mendoni se punët shkojnë më mirë në anën tjetër, ku dëshira e Tjetrit bazohet mbi çfarë quhet liri, apo me fjalë të tjera padrejtësi? Në një vend ku ti mund të thuash çfarë të duash, madje edhe të vërtetën, rezultati është se, çfarëdo që të thuash, nuk ka asnjë lloj efekti.

Dua ta mbyll këtu, me qëllim që t'ju them se mund të vijë një kohë që ta kuptojmë se të jesh psikanalist do të thotë të mundesh të kesh një vend në shoqëri.

Atë vend do ta zënë shpresoj, madje jam i sigurt; edhe pse për momentin atje sheh vetëm psikanalistë të strukur në kthinën e tyre të vogël të magjive.

Psikanaliza, natyrisht, mund të jetë një regjim, një regjim shkencor i qasjes ndaj gjithçkaje



që ka lidhje me subjektin. Megjithatë, do të vijë duke u bërë gjithnjë e më e dobishme që ta ruajmë, në mes të kësaj rrokullime gjithnjë e marramendëse që e ka kapur botën tonë.

## Diskutim

*Henri Maldiney*: Si mund ta diskutojmë ligjëratën tuaj? Do të na duhet ta bëjmë nëpërmjet një pluraliteti pikëpamjesh dhe duke u futur në nyjëtimet e saj, çka nuk mund ta bëjmë për të gjitha çështjet. Do t'ju bëj pra një pyetje të thjeshtë për dallimin mes dy subjekteve tuaja.

Më duket sikur ju e mbi-thjeshtoni të parin, atë që, pikërisht, nuk ka asnjë kuptim leksikor, atë që përcaktohet vetëm nga akti i të folurit, atë që nuk përcaktohet thjesht nga të gjitha semantemat e mundshme të fjalës, të cilat në fakt nuk janë kurrë të kulluara; as nga bashkësia e morfemave, por nga mundësitë e brendshme të një situate.

Më duket sikur, meqë ju e anashkaloni këtë, ju bini në kundërshtim me Heidegger-in, të cilin sapo e cituat, sepse *archè*-ja e Heidegger-

it është në thelb një prani ose nyjëtim që ekziston para çdo strukture morfologjike, para se të bëhet kuptim. Ajo është, para së gjithash, sovrane në përmasën konkrete dhe jashtë kuptimit, në vetë situatën. Sa kohë që *uni* që flet dhe *ti*-ja, ose tjetërsia që ka nevojë, kërkon... sepse, nëse gjithçka është e qartë, atëherë nuk mbetet më asgjë. Çfarë dua të them është se, nëse tjetri nuk reziston, *uni* nuk mund ta gjejë vetveten.

Tani, *uni* [fr. *je*] që përftohet kështu, i shpëton legjislacionit të gjuhës, përveçse në logjikën predikative; dhe mua më duket se, për shkak të logjikës së parashtresës suaj, dhe duke përcaktuar subjektin e thëniezimit, ju futeni në një logjikë predikative. Tani, logjika predikative nuk është, në fund të fundit, veçse një formë e logjikës, dhe është sigurisht logjikë e objektit më shumë sesa e marrëdhënies subjekt/objekt.

Më konkretisht, objektivizimi i pranishëm në atë logjikë mua më duket krejt i kundërt me ndonjë nocion të *insight*-it [anglisht në origjinal], sepse nuk është asgjë më tepër sesa faza e dytë e singularizimit të një funksioni



shumë më themelor, dhe pikërisht i të qenit në botë. Tani, të qenët në qendër të kësaj logjike dhe të qenët në botë nuk janë e njëjta gjë. Ju rrezikoni të mbeteni brenda fushës së çfarë është përftuar [*acquis*], për ta thënë me Husserl-in.

Dhe në lidhje me sendin, ose më mirë nyjëtimin e sendeve, që është gjithnjë i pranishëm te Heidegger-i, unë nuk arrij të shoh se çfarë pranie mund të ketë, nëse gjuha bëhet vërtet shenja, ose çfarë unë do ta quaja forma e absolutes, përtej parimit të realitetit, çka është e kundërt me *Verneinung*-un e Freud-it, të cilin ju...

*J.L.:* Po nuk kam thënë as edhe një fjalë të vetme për *Verneinung*-un sot.

*Henri Maldiney:* Jo, dhe megjithatë po; meqë ndrymja [*refoulement*] nuk hiqet nga kuptimi intelektual i paraqitjes mendore dhe se kuptimin e arrijmë nëpërmjet gjuhës. Mua më duket se vetë gjuha nuk është bashkëkohore dhe nuk lind nga koha. Në përgjithësi, gjuha arrin të bëjë pa kohën dhe kuptimi është, në

thelb, i kthyeshëm. Dhe vetëm në të tashmen mund ta rikuperojmë çfarë nuk gjendet thjesht në kuptim...

*J.L.:* Mos shkoni më tej, ju lutem. Unë pretendoj ta ndjek Heidegger-in vetëm deri në atë masë sa t'ia lejoj vetes ta citoj, për të gjetur një formulë efikase. Edhe po të supozojmë se pati njerëz, në auditor, që e menduan atë lidhje, unë menjëherë e sqarova se unë po e merrja hua atë formulë, dhe pikërisht ashtu bëra. Çfarë bën Heidegger-i me të, kjo është çështje tjetër.

Nga ana tjetër, për t'iu përgjigjur asaj që mua më duket se është çështja kryesore që ngrini, unë nuk e kuptoj pse thoni se unë e sakrifikoj subjektin e nyjëtimit, të *archè*-së, të situatës së subjektit sa kohë që ai flet dhe dëgjon, në atë masë që ai futet në situatën e tashme *si* qenie në botë, siç thoni ju, sepse unë pikërisht për këtë arsye flas për 'ndarje të subjektit.'

Po them, pra, se subjekti, gjithë duke mbetur subjekt, funksionon vetëm kur ndahet. Në fakt, kjo është krejt teza ime. Më duhet t'ju them se këtë ndarje të subjektit unë e konsakroj,



e shpall dhe e demonstroj në mënyrë shumë të ndryshme nga ajo reduktive që përdora këtu dhe që, në fakt, nuk i përgjigjet aspak ndarjes vetë. Përndryshe do të kisha bërë diçka që unë absolutisht refuzoj: t'ju jepja referenca sonte; sepse atë do ta kisha bërë sikur të flisja për çka, me lejen tuaj, do ta quaja jo vetëm mësimin tim por doktrinën time dhe gjithçka rrjedh prej saj. Por nuk e kam bërë këtë.

Ka një element shkakësor në këtë ndarje, të cilin unë e quaj *objet petit a*. Ka mes jush nga ata që e kanë dëgjuar këtë term, ka edhe nga ata që nuk e kanë dëgjuar. Atyre që s'kanë dëgjuar, mund t'u duket si diçka e çuditshme, sidomos ngaqë unë nuk pata kohë që të sqaroj se cilit rend i përket ky, dhe ngaqë ai lidhet ngushtë me strukturën e dëshirës. Gjithsesi, ky *objet petit a* gjendet në të njëjtin vend ku zbulohet mungesa fallike, në rrënjë të çka unë u përpoqa këtu ta vendos në qendër, sepse është vërtet qendra e përvojës psikanalitike – dhe pikërisht ajo çka unë, si gjithkush tjetër, e quaj kastrim.

Kështu, për të thënë se subjekti ishte i ndarë, unë thjesht tregova dy pozicionet e

tij në marrëdhënie me funksionin në gjuhë. Subjekti ynë si i tillë, subjekti që flet, nëse dëshironi, mund të pretendojë përparësi, por kurrë nuk do të jetë e mundshme ta shohim thjesht si nismëtarin e lirë të ligjëratës së vet, ngaqë, si i ndarë që është, ai mbetet i lidhur me atë subjektin tjetër – subjektin e së pavetëdijshmes, i cili në fakt ekziston i varur nga struktura gjuhësore. Ja se çfarë është zbulimi i së pavetëdijshmes.

Tani kjo ose është e vërtetë, ose jo. Nëse është e vërtetë, atëherë edhe Heidegger-i duhet të pushojë së foluri kësisoj për subjektin. Dhe veç kësaj, nëse përfshihemi në këtë debat për Heidegger-in, do të më duhet të vë në dukje se përdorimi i termit 'subjekt', nga Heidegger-i, nuk është aspak konsistent.

*Henri Maldiney*: Ai gati s'e përdor fare.

*J.L.*: Tamam. Unë e përdor.

*Henri Maldiney*: Ju keni arsyet tuaja.

*J.L.*: Kam arsyet e mia dhe po përpiqem t'i shtjelloj tani për ju. Në kontekst, ju shprehët



disa rezerva duke sjellë në vështrim një numër regjistrash të doktrinës së Freud-it: ndrymja, *Verneinung*-u, dhe një mori gjërash të tjera. Pa diskutim, të gjitha këto kanë luajtur një rol dhe janë shoshitur përmes mendimit tim gjatë shtatëmbëdhjetë vjetëve të fundit, ose më mirë, që kur kam nisur të merrem me... çfarë kam ardhur të prezantoj këtu, ose më mirë të evokoj me tre referencat që i quaj, me radhë, 'vendi, origjina dhe qëllimi i mësimit tim'. Objeksionet tuaja, dhe që natyrisht vlejnë, lidhen me një perspektivë të caktuar. Dhe unë e kam të qartë se çfarë kërkoni ju të ruani, duke i shprehur; qoftë edhe vetëm ngaqë, për t'jua demonstruar këtë, do të duhej një dialog shumë më të gjatë se ky që mund të kemi këtu.

*Henri Maldiney*: Nuk mohoj atë çfarë thoni ju për të pavetëdijshmen. Njëlloj siç e shndërroni ju në gjuhë, Husserl-i e shndërron në 'inaktualitete'. Prandaj ne s'mund të kemi një dialog, por le ta quajmë thjesht monolog të dyfishtë.

*J.L.*: Kjo nuk është se kufizohet vetëm me çfarë ndodh mes filozofësh. E njëjta gjë ndodh edhe mes burrit dhe gruas.



*Mësimi im.*
*Natyra dhe qëllimet e tij*

Pranova të vizitoj një klinikë psikiatrike sepse kisha të drejtë të besoj se nuk më kishin ftuar kot për të marrë pjesë në një *kolokuium*, siç e quajmë në zhargonin modern.

Nuk është i keq, ky term. Më pëlqen mjaft. Ne flasim së bashku, në të njëjtin vend. Kjo nuk do të thotë, medoemos, se edhe po mendojmë. Secili prej nesh flet, sepse ne jemi në të njëjtin vend: ne bashkë-flasim.[2] 'Kolokuium' është term pa pretendime, ndryshe nga 'dialog'. Të jesh në dialog është një nga pretendimet më të mëdha të kohëve të tanishme. Keni parë ndonjëherë njerëz në dialog? Ato situata që na

[2] Lacan-i këtu i referohet termit latin *colloquium*, i cili shpjegohet si "të folur së bashku" (co-lloquium, ku *loquium* vjen nga folja *loqui*, flas); por duket sikur ka në mendje edhe një lojë fjalësh, me latinishten *locus*, "vend", e cila në fakt nuk ka të bëjë etimologjikisht me *colloquium*.

duken si dialog, gjithnjë u ngjajnë nga një çikë zënkave të çiftit.

Prandaj, shpresoja të flisja bashkë me ju, ose të bashkë-flisja. Por meqë ka kaq shumë prej jush këtu, kjo do të jetë shumë më e vështirë se ç'kujtoja.

Në fakt, nuk kam përgatitur asgjë të destinuar posaçërisht për ju. Dhe s'e kam problem t'jua shpjegoj psenë. Po të kisha ardhur këtu për të thënë diçka para jush, dhe të kisha gjetur vetëm heshtje në praninë tuaj, do të më ishte dukur sikur po imitoja farëhedhësen (*la semeuse*)[3]. Mirëpo që ju jeni ulur në radhë, kjo s'i bën këto radhë brazda, as do të thotë se farat do të gjejnë dhé kujn të mbijnë. Prandaj do të dëshiroja që të pranishmit të kenë mirësinë të më bëjnë pyetje.

E di që kjo nuk ka shumë të ngjarë që të ndodhë, natyrisht, por unë kështu e kam zakon të bëj, sa herë që më qëllon, dhe në fakt jo shumë shpesh, të flas në një mjedis që nuk e njoh mirë, meqë unë besoj se nuk

[3] Një figurë gruaje që hedh farën në arë, që del në disa pullа poste franceze, si dhe në monedha dhe në kartëmonedha të atij vendi.



janë të shumtë ata mes jush, që i kanë ndjekur mësimet e mia.

## 1

Çfarë mësoj unë ka bërë pak bujë.

Kjo që nga dita – të cilën, falë Zotit, e vonova aq sa munda – kur unë mblodha bashkë ca tekste që m'u desh t'i quaj pastaj *Shkrime* [*Écrits*], në shumës, sepse m'u duk se ajo ishte mënyra më e thjeshtë për t'i vënë një emër asaj çka do të bëja.

Grumbullova, nën atë titull, disa gjëra që kisha shkruar, thjesht për të vënë ca shenja dalluese, ca gurë kilometrikë, si ato pilotat që ngulin në det, për të lidhur varkat; ca shenja, pra, në çfarë u kisha mësuar të tjerëve, çdo javë, për nja njëzet vjet. Nuk besoj se e përsërita shumë veten. Madje jam i sigurt se nuk e përsërita, sepse ia vura vetes si rregull, ose si detyrim, që kurrë të mos e them diçka më shpesh se një herë. Dhe kjo s'ishte aspak e lehtë, doemos.

Gjatë atyre viteve të gjata që kam dhënë mësim, herë pas here më qëllonte të hartoja

një *shkrim* dhe më dukej e rëndësishme që ta lija atje, si piketë, për të shënjuar një fazë, ose se ku kishim arritur këtë apo atë vit, ose gjatë një periudhe të vitit. Pastaj i mblodha të gjitha bashkë. Kjo ndodhi në një kontekst në të cilin shumë gjëra kishin ndryshuar, që nga koha kur unë kisha nisur të jepja mësim.

Unë u drejtohesha atyre njerëzve të cilët merreshin me këto punë, pikërisht atyre që e quajnë veten psikanalistë. Kjo kishte të bënte me përvojën e tyre më të drejtpërdrejtë, më të përditshme, më urgjente. E bëra shprehimisht për ta, jo për këmd tjetër. Por, në fakt, e kam menduar se mund t'u interesonte edhe njerëzve të tjerë, të cilëve nuk u ishte drejtuar dhe me të cilët nuk kish ndonjë lidhje. Çdo ndërmarrje e kësaj natyre ka gjithnjë natyrë shembullore, në atë masë që përballon një vështirësi që ti mund ta ndiesh, ose diçka e vërtetë, konkrete, për ta thënë me një fjalë të modës. Edhe sikur ju të mos e kuptoni shumë mirë, leximi i çfarë kam shkruar e ka një efekt, jua ngre mendjen, është me interes. Nuk ndodh kaq shpesh që të lexoni një *shkrim* që të jetë detyrimisht diçka urgjente, dhe që t'u drejtohet njerëzve



që vërtet kanë diçka për të bërë, diçka që nuk është e lehtë për t'u bërë.

Është kryesisht për këtë arsye, besoj, se, po t'u qasemi atyre nga një këndvështrim tjetër, mund të biem dakord që t'i quajmë këto *Shkrime* si të palexueshme; njerëzit të paktën bëjnë sikur i lexojnë, ose sikur i kanë lexuar. Natyrisht, jo ata njerëz që, pas gjase, e kanë këtë profesionin e tyre, ose, me fjalë të tjera, kritikët. Kjo t'i detyronte ta provonin vlerën e tyre, duke shkruar diçka që mund të ketë të bëjë, sado pak, me çfarë them unë, por në atë pikë ata fillojnë të bëhen dyshues. Siç mund ta keni vënë re, për këtë libër nuk ka pasur shumë analiza kritike. Ndoshta ngaqë është i vëllimshëm, i vështirë për t'u lexuar, i errët. Nuk është destinuar aspak për konsum të përditshëm. Ju mund të më thoni se, duke u shprehur kështu, unë po përligj veten. Në kuptimin se unë po them se duhej të kisha shkruar një libër për konsum të përditshëm, ose edhe që do ta bëj këtë dikur. Ka mundësi. Mund të provoj ta bëj. Por nuk është diçka që më vjen ndoresh. Dhe s'është fare e sigurt se do t'ia dal mbanë. Ndoshta do të ishte më mirë që

të mos e detyroja veten. Aq më tepër që s'më duket veçanërisht e dëshirueshme në vetvete, meqë çfarë u mësoj unë të tjerëve do të bëhet, herët a vonë, e njohur. Do të ketë njerëz që do të merren me të dhe do ta kalojnë dora-dorës. Natyrisht, s'është e njëjta gjë, sepse mund të shtrembërohet një çikë. Ata do të përpiqen t'ia japin kallaballëkut. Do të bëjnë ç'është e mundur që ta ripozicionojnë në raport me disa nga ato bindjet shumë solide, që i shkojnë për shtat gjithkujt në këtë shoqëri, si në çdo shoqëri.

Unë s'kam fare ndër mend t'ia bëj këtu kritikën shoqërisë ku jetojmë. Nuk është as më e mirë, as më e keqe se të tjerat. Shoqëria njerëzore gjithnjë ka qenë marrëzi. Kjo nuk është se ia ul vlerat. Gjithnjë ka qenë e tillë, gjithnjë do të jetë. Tek e fundit, duhet pranuar se shumë ide po i marrim tashmë të parapërtypura. Gjithçka është vijim i diçkaje tjetër. Kjo na bën të gjithëve ne të na merren pak mendtë. Ja, tani, kur po hanim drekë, së bashku me grupin që më mirëpriti, po flisnim për atë që e quajnë TV, atë gjënë që të lejon të mbërrish në skenën e botës, të mbahesh në



korrent me ngjarjet në botë në çdo çast, me çdo gjë kulturore. Asgjë kulturore nuk do t'ju shpëtojë më.

Meqë jemi në temë, dua t'ju tërheq vëmendjen për një ndryshim të rëndësishëm, që ndoshta nuk është nxjerrë në pah sa duhet, mes njeriut dhe kafshëve. Ia vlen të përmendet, pikërisht ngaqë ne e harrojmë. Po flas për një ndryshim në kontekstin natyror, meqë vërtet nuk dua të ngatërrohem me antropologji kulturore.

Ndryshe nga çfarë ndodh në çdo nivel të mbretërisë shtazore – që nis me elefantët dhe hipopotamët dhe përfundon me kandilat e detit – njeriu karakterizohet nga turpi që ndien për – po si ta quajmë vallë? Me emrin e vet, natyrisht – të dhjerët.

Njeriu është e vetmja kafshë për të cilën kjo është problem, dhe çfarë problemi! Ju nuk e kuptoni, meqë ju përdorni pajisje të posaçme për ta larguar. Ju nuk keni asnjë ide se ku shkon jashtëqitja juaj më pas. Ajo qarkullon nëpër kanale dhe pastaj grumbullohet në ca vende të cilat ju s'i keni parë ndonjëherë dhe mandej ka fabrika që e marrin, e përpunojnë dhe

nxjerrin prej saj gjithfarë gjërash që kthehen në qarkullim nëpërmjet industrisë, dhe industria njerëzore është një industri krejtësisht e ndërthurur. Për çudi, nuk ekziston, me sa di unë, ndonjë kurs në ekonomi politike që t'i kushtojë kësaj ndonjë leksion. Është një dukuri e ndrymjes që, si të gjitha dukuritë e ndrymjes, lidhet me nevojën për mirësjellje. Vetëm se nuk kuptohet mirë për cilën.

Kam takuar një herë, shumë kohë më parë, një burrë të mençur; dhe më vjen keq që s'pata rast ta njoh më mirë: Aldous Huxley-n. Ishte burrë i këndshëm, me prejardhje nga familje e mirë, dhe nuk ishte budalla, nuk ishte hiç budalla. Në fakt, s'e di nëse është akoma gjallë. Gjejeni librin e tij *Adonis dhe alfabeti*. Ekziston një përkthim frëngjisht, i botuar nga Stock, nëse nuk më tradhton kujtesa. Titulli nuk na thotë gjë, sidoqoftë, për kapitullin që trajton pikërisht çfarë po ju flisja këtu: trajtimin e plehrave.

Të flasësh për këtë gjë është gjithnjë shokuese, edhe pse si veprimtari ajo ka qenë gjithnjë pjesë e çfarë quajmë qytetërim. Çdo qytetërim i madh është, para së gjithash,



qytetërim që ka një sistem për trajtimin e plehrave. Sa kohë që nuk e marrim këtë si pikënisje, nuk do të themi dot asgjë për të qenë.

Mes atyre njerëzve që i kemi quajtur, prej disa kohësh, primitivë, edhe pse unë nuk e kuptoj dot pse i quajmë ashtu, meqë ata nuk kanë asnjë gjurmë primitiviteti; prandaj le të themi më mirë në shoqëritë që studiohen prej etnologëve – edhe pse, tani që kjo u ka rënë në dhëmb teoricienëve, dhe këta i japin gojës për primitiven, arkaiken, paralogjiken dhe profka të tjera si këto, askush nuk është në gjendje t'i kuptojë më – pra, këta njerëz, siç po thosha, nuk e kanë shumë problem trajtimin e plehrave. Nuk është se po them se nuk e kanë fare problem. Dhe ndoshta pikërisht ngaqë nuk e kanë shumë problem, ne i quajmë të egër, madje edhe të egër fisnikë, dhe i shohim si njerëz që janë më afër natyrës.

Mirëpo kur vjen puna te ekuacioni *qytetërim i madh = kanalizime ujërash të zeza*, këtu s'ka përjashtime. Në Babiloni kishte kanalizime të tilla, dhe Roma ishte plot me të tilla. Ashtu filloi Qyteti I Përjetshëm, me *Cloaca maxima*.

Ishte i parathënë për të sunduar botën. Prandaj duhet të jemi krenarë me këtë. Arsyeja pse nuk jemi është se, po t'i japim kësaj dukurie çfarë mund ta quanim si rëndësinë e saj themelore, do të zbulonim analogjinë e habitshme që ekziston mes plehrave dhe kulturës.

Kultura nuk është më privilegj. Bota mbarë është krejt e mbuluar me të. Kultura të ngjitet në lëkurë. Të ngecur siç jemi brenda këtij zhgualli të madh plehrash që vijnë nga i njëjti vend, bëjmë ndonjë përpjekje të dobët për t'i dhënë formë. Dhe ku përfundon e gjithë kjo? Te idetë e mëdha, siç i quajnë. Historia, për shembull.

Gjithnjë hyn në punë historia, apo jo? Nuk ka vetëm një kuptim; por një mijë e një kuptime. Ka njerëz që kërkojnë atje mbështetje. Jo se do të merrnin mundimin të lexonin se çfarë thotë Hegeli për këtë temë, natyrisht. Pati edhe të tjerë para tij, Bossuet-ja, për shembull. Ky e vuri gjithçka në duart e Perëndisë. Kjo, të paktën, ishte e qartë. Më duhet të pohoj se e vlerësoj shumë *Ligjëratën për historinë universale*. Para së gjithash, sepse kjo e përuroi zhanrin dhe e bëri këtë në bazë



parimesh të qarta. Është Zoti që i lëviz gurët në tabelë. Kjo vërtet meriton të quhet histori – gjithçka sillet rrotull historisë se çfarë i ndodhi një farë zotërie. Jo keq, vërtet; ua hapi oreksin edhe të tjerëve, dhe i dha thellësi të madhe historisë. Nuk po them se të gjitha këto ide janë të papranueshme, por ca i kanë përdorur në mënyra nga më të çuditshmet.

Jo se dua t'ju bëj të besoni se kultura është një synim që unë nuk e miratoj. Aspak. Ajo na çliron. Na çliron krejt nga funksioni i të menduarit. Na çliron nga e vetmja gjë që ka ndonjë interes sado të vogël në atë funksion, i cili është krejt inferior. Unë nuk arrij të shoh pse duhet t'i atribuojmë ndonjë lloj fisnikërie dukurisë së të menduarit. Për çfarë mendojmë vallë? Për gjëra mbi të cilat nuk kemi asnjë lloj kontrolli, gjëra që duhet t'i kthejmë përmbys, pastaj prapë mbarë, pastaj prapë përmbys, me dhjetëra herë, në të njëjtën mënyrë, para se të arrijmë t'i kuptojmë. Ja, këtë e quajmë mendim. Kur unë mendoj, unë përpiqem, unë rrëmoj rreth e rrotull. Gjërat fillojnë të bëhen interesante vetëm kur të menduarit bëhet i përgjegjshëm ose, me fjalë të tjera, kur arrin një

zgjidhje, sa më të formalizuar aq më mirë. Nëse nuk mbërrin në një formulë, një formalizim, sa më matematik që të jetë e mundshme, nuk mund të gjejmë aty as interes, as fisnikëri. Nuk shohim arsye për t'u marrë me të.

Qëllimi i historisë është të shkruajë historinë e mendimit, dua të them, të mënjanojë përpjekjet e vogla, të ndrojtura por që, të them të vërtetën, janë shpesh të lavdërueshme, skrupuloze – dhe ato mbijetojnë më mirë se të tjerat – që ka bërë ky apo ai për të zgjidhur disa probleme të caktuara. Si rezultat, profesorët tanë do të viheshin në siklet kur t'u duhej të merrnin një qëndrim dhe të thoshin se çfarë mendojnë për logjikën e Descartes-it, ose për ca nga ata që kanë dalë nga shinat, të thonë nëse i qëndron kritikës apo i ka ardhur fundi – por është shumë më e lehtë të shkruash historinë e mendimit, që për ta do të thotë të kërkojnë se çfarë i kanë përcjellë njëri-tjetrit. Kjo është mahnitëse, sidomos kur është profkë dhe kur ju e shihni se çfarë lloj gjërash kanë mbijetuar.

Mekanizmi që po ju tregoj punon në mënyrë shumë bashkëkohore. Nuk është teori,



dhe unë nuk kam ardhur këtu t'jua vë teorinë në piedestal. Ju mund ta shihni me sytë tuaj, pa shkuar në universitet, ku këto gjëra jua mësojnë si 'filozofi'.

Ju i dini marrëzitë që kanë nxjerrë tani. Paska strukturë, paska dhe histori. Njerëzit që i kanë futur në kategorinë e 'strukturës', ku përfshihem edhe unë – nuk u futa vetë aty, më vunë ata, ja kështu – pas gjasc, pështykan mbi historinë. Kjo është absurde. Natyrisht nuk mund të ketë strukturë, pa iu referuar historisë. Por më parë, ju duhet ta dini se për çfarë po flisni, kur flisni për strukturë. Do të përpiqem t'ju them diçka për këtë.

Është gjithnjë e vështirë ta përshkruash me pak fjalë se çfarë po ndodh në fushën për të cilën po diskutojmë, pa krijuar keqkuptime. Fjalët shpesh janë rrethuar me gjithfarë lloj pështjellimesh, për pak si shumë gjatë. Kjo tani po i lejon disa që të përdorin reduktimin historik, që s'ka asgjë të përbashkët me të drejtat teorike, nëse mund t'i quajmë kështu, të funksionit të historisë. Kështu, tani dalin dhe bëjnë pyetje që kanë të bëjnë jo me strukturën, por me çfarë ata quajnë strukturalizëm.

Për shembull, gjatë një bisede para se të vija këtu, dikush, një person shumë i respektueshëm, më tha 'A nuk mund të thoni se si lidhet puna juaj, ajo me çfarë merreni, me strukturalizmin?' Dhe unë iu përgjigja: 'Pse jo?' Prandaj le t'i parashtrojmë gjërat si duhet dhe ta përshkruajmë procesin.

Funksioni i çfarë quajmë lëvizje ose prirje kulturore është të përziejë dhe të homogjenizojë. Diçka që del në dritë, ka disa cilësi, një farë freskie, një si majë. Është një syth. Prirja kulturore, që përmenda më lart, e përpunon këtë, derisa ajo reduktohet krejtësisht, bëhet e neveritshme dhe komunikon me gjithçka.

Duhet thënë se kjo nuk është gjë për t'u përshëndetur, gjithsesi. Jo për arsye që lidhen me ndonjë nevojë të brendshme, por për arsye komerciale. Kur e çrrënjosin, ajo shteron. Edhe pse unë kam përdorur fjalë të ndyra tashmë, besoj se mund të guxoj ta përsërit formulën që më ka shkuar në mendje, në këtë kontekst. Të hash fekale është shumë mirë, por ti nuk mund të hash gjithnjë të njëjtën fekale. Prandaj, unë përpiqem të gjej fekale të re.

Kjo modë e re, që ju e quani 'strukturalizëm', e ka zanafillën në orvatjet për të bashkërenduar



njerëz që nuk futen kollaj në kategori, që kanë qëndruar në qoshet e tyre. Duhen studiuar të gjitha proceset, të gjitha funksionet e rezistencës që i lanë ata të izoluar, dhe pastaj i lidhën ata me njëri-tjetrin, i asimiluan dhe i mblodhën bashkë. Unë kam pasur një fat të jashtëzakonshëm të jem njëri prej tyre dhe ndihem mirë për këtë. Këta janë njerëz që iu qasën gjërave pak më seriozisht. Nderime, Lévi-Strauss. Me siguri nuk do të jemi në gjendje ta përsëritim këtë sukses në të ardhmen. Do të na merret fryma. Pastaj ka të tjerë. Nxjerrin ndonjë të ri, herë pas here.

Hë për hë, po bëjnë një përpjekje të njëmendtë për ta hedhur të gjithë këtë në qarkullim të përgjithshëm, po përpiqen vërtet. Dhe kjo nuk është zgjidhje e keqe. Deri më tani, unë i kam rezistuar këtij operacioni, sepse ata nuk e dinë mirë se nga ç'anë t'i kapin ato që them unë. Nuk e dinë sepse s'kanë asnjë ide se me çfarë kanë të bëjnë fjalët e mia, edhe pse iu duket sikur dinë se në ç'kategori t'i futin. Duhet të luftojnë për t'i përvetësuar, siç bëjnë me gjithçka tjetër, por nuk dinë se si.

Do ta gjejnë një mënyrë. Sidomos po t'i ndihmoj unë.

## 2

S'do mend që, çfarë mësoj unë, ka lidhje me atë që e quajmë përvoja psikanalitike.

Ata duan ta transformojnë të gjithë këtë në diçka që nuk e ndihmon gjë dijen, diçka që e quajnë me një emër të bukur që tingëllon si teshtimë, në një *Weltanschauung*. Po unë nuk mund ta ngre hundën kaq përpjetë. Kjo është gjëja që urrej më shumë. Kurrë nuk ia lejoj vetes, falë Zotit. Asnjë *Weltanschauung*! As *Weltanschauungen* të tjera! Ato ma shpifin mua.

Çfarë mësoj unë, ka të bëjë me diçka shumë të ndryshme, me procedura teknike dhe detaje formale që kanë lidhje me një përvojë që ose është shumë serioze, ose është një lajthitje e jashtëzakonshme, diçka e marrë, diçka delirante. Dhe ashtu duket nga jashtë. Gjëja themelore, në lidhje me analizën, është se njerëzit më në fund e kuptojnë se kanë folur marrëzira, me volum të lartë, për vite me radhë.

Sa për mua, unë përpiqem të tregoj, duke u nisur nga një sqarim i *raison d'être* të saj, se



pse ajo zgjat, pse vazhdon, pse përfundon si diçka që shpesh nuk ngjan fare me atë çfarë kujtohet se i duhet shpallur botës mbarë, çfarë pretendohet se dihet në lidhje me funksionimin e saj. Natyrisht, ky është një operacion ligjërator, një operacion-ligjëratë. Do të më thoni se ka njerëz që e fillojnë dhe e mbarojnë analizën pa thënë një fjalë të vetme. Nëse ndodh ashtu, kjo heshtje e tyrja është elokuente.

Neve nuk na u desh të prisnim për analizën, që të fillonim të interesoheshim për ligjëratën. Në të vërtetë, ligjërata është pikënisja për gjithçka shkencore. Nuk mjafton që vetëm ta imagjinosh filozofinë në regjistrin për të cilin po ju flisja, d.m.th. si ndodhi që mendime të bukura u përcollën dora-dorës në shekuj. Nuk është fjala për këtë. Qëllimi i filozofisë është të specifikojë se deri në ç'masë mund të nxjerrim, nga një operacion-ligjëratë, gjëra që mund të përshkruhen me siguri si shkencë.

Shkencës i është dashur kohë të formohet; shkencës sonë, që pa dyshim e ka provuar vlerën e vet – se për çfarë, kjo mbetet për t'u parë, por të paktën për efektivitet. E gjithë

puna ka lidhje me përsosjen e përdorimit korrekt të ligjëratës dhe asgjë tjetër.

Po përvoja ku hyn këtu, do të më pyesni. Çështja këtu është se përvoja përftohet si e tillë vetëm në qoftë se e nisim duke bërë pyetjen e duhur. Këtë e quajmë hipotezë. Pse hipotezë? Hipoteza është thjesht një pyetje e bërë siç duhet. Diçka, me fjalë të tjera, nis të marrë formë si fakt, dhe fakti është gjithnjë ligjërator.[4] Askush nuk ka parë ndonjëherë një fakt të trashëguar. Ai nuk do të ishte fakt. Do të ishte një masë, një diçka me të cilën përplasesh, ose çdo gjë tjetër që mund të thuhet për diçka ende të panyjëtuar në ligjërim.

Psikanaliza, që është një lloj absolutisht i ri ligjërimi, na fton t'i hedhim edhe një sy tjetër shtrimit të problemit në rrënjë. Na nxit, për shembull, të hetojmë dukurinë e shfaqjes së një logjike, aventurat e saj dhe gjërat e çuditshme që ajo na tregon.

Na ishte një herë një Aristotel dhe pozicioni i tij – se çfarë do të mendoni ju pas kësaj deklarate simes nuk ka shumë rëndësi – nuk

[4] Këtu origjinali ka një lojë fjalësh, midis emrit *fait* "fakt" dhe foljes *fait* (*faire*) "bëj".



ishte i pangjashëm me timin. Ne nuk e dimë mirë se me çfarë ose me kë i ishte dashur atij të merrej. Këta i quanin, në mënyrë të paqartë dhe të pështjelluar, sofistë. Ne doemos duhet t'i marrim me rezervë këta terma, të jemi shumë të kujdesshëm. Në fakt, nuk dihet fare se çfarë mësonin njerëzit prej sofistëve. Ndoshta diçka efektive, sepse e dimë që këta paguheshin shumë mirë, njëlloj siç i paguajmë ne sot psikanalistët. Aristoteli pa dyshim nxori edhe ai diçka që andej, por kjo nuk pati asnjë efekt ndaj njerëzve të cilëve u drejtohej. Ashtu ndodhi me të, ashtu po ndodh edhe me mua. E njëjta gjë. Çfarë them unë, nuk ndryshon asgjë për psikanalistët, as i ngroh as i ftoh. Por le të vazhdojmë, të vazhdojmë dhe të shpresojmë.

Ato gjëra të mrekullueshme që gjejmë në *Analizat parësore*, në *Analizat dytësore* dhe në *Kategoritë* janë çfarë i quajmë logjikë. Sot e kanë humbur vlerën, sepse jemi ne ata që bëjnë logjikë të mirëfilltë, serioze, edhe pse nuk kemi shumë kohë që e bëjmë; që nga mesi i shekullit XIX, rreth 150 vjet.

Logjika korrekte, e rreptë, e vërtetë filloi me një farë Boole. Kjo na jep mundësinë t'i

rishohim disa ide. Ne gjithnjë kujtonim se, pasi të kishim përcaktuar disa parime të mira që në krye, gjithçka që do të nxirrnim prej tyre do të funksiononte pa probleme dhe se gjithnjë do të binim, si të thuash, në këmbë. E rëndësishme ishte që një sistem të mos ishte kontradiktor. Kjo ishte gjithë logjika. Mirëpo pastaj ne vëmë re se punët nuk janë fare kështu. Zbulojmë shumë gjëra që na kishin shpëtuar. Nëse ka njerëz këtu që kanë dëgjuar ndonjëherë për një farë Gödel-i, do ta dinë se edhe aritmetika nuk paska qenë veçse kanistër; në kuptimin që paska pasur shumë, shumë vrima në fund. Gjithçka firon dhe zhduket nëpërmjet një vrime në fund.

Kjo është me interes, dhe vetë interesimi për të mund të ketë fare mirë vlerë formuese për psikanalistin. Mirëpo, hë për hë, nuk na shpie gjëkundi, sepse këtu na del një problem shumë i veçantë, që unë e quaj problemi i moshës. Nëse ju dëshironi të merreni me logjikë, ose me gjithçka tjetër që ka të bëjë me shkencën moderne, duhet ta filloni këtë para se të jeni budallallepsur krejt – nga kultura, e kam fjalën. Natyrisht, ne jemi të gjithë pak



të budallallepsur, meqë arsimit të mesëm nuk i shpëtojmë dot. Tani, edhe shkolla e mesme mund të ketë vlerën e vet, sepse ata që i mbijetojnë pa e humbur krejt gjallërinë shkencore, janë raste më vete, siç do t'iu thotë gjithkush. Miku im i mirë Leprince-Ringuet, që u budallalleps në të njëjtën kohë me mua në shkollë, i shpëtoi kësaj menjëherë, në mënyrë brilante dhe gjallërisht. Për mua, u desh psikanaliza që të më nxirrte. Duhet thënë se jo shumë njerëz kanë përfituar prej saj siç kam përfituar unë.

Logjika është diçka shumë precize dhe kërkon një lloj përkulshmërie mendore që të mos jetë konsumuar krejt nga të gjitha ato gjëra idiote që të futin në kokë. Prandaj unë duhet ta kem pasur në moshë shumë të re. I vetmi problem është se, kur je shumë i ri, kjo nuk është koha më e mirë për të qenë psikanalist i mirë. Ndërsa kur ndonjëri, që ka një farë përvoje, qëllon të bëhet psikanalist, është shumë vonë për t'i mësuar atij gjëra të dorës së parë, që do ta përgatitnin për këtë lloj praktike të veçantë.

E përmenda logjikën, për t'jua dhënë një pikë referimi. Ka edhe gjëra të tjera, por logjika

është shembullore kur e marrim në nivelin e Aristotelit, sepse ai vërtet u rrek të niste diçka, të përuronte diçka. Natyrisht, ata të tjerët, sofistët, po e përdornin tashmë logjikën dhe në mënyra të habitshme, shumë brilante, shumë efektive, në një nivel të caktuar arsyeshmërie. Që nuk ishin ata që ia dhanë emrin, kjo nuk do të thotë se nuk po e përdornin, pa dyshim. Dhe nuk do të kishin qenë kaq të zotët për t'i joshur qytetarët, dhe jo-qytetarët, dhe për t'u dhënë këshilla si të fitonin debatet ose si të debatonin për çështjet e përjetshme të qenies dhe të mosqenies, sikur logjika të mos kishte një efekt formues. Aristoteli u mundua të përsosë një teknikë, të cilën e quajnë *Organon*. Ai përuroi brezninë e filozofëve, edhe pse kjo brezni është mrrudhur pak, tani që filozofinë e kanë katandisur në histori të mendimit. Çfarë do të thotë se e kemi pisk. Për fat, kanë mbetur disa kallpazanë aty-këtu, që përpiqen t'ju kthejnë në shalë të kalit. Këta i quajnë fenomenologë.

Psikanaliza na jep një shans, një shans për të filluar përsëri.



## 3

Siç jua shpjegova, besoj, ka një lidhje shumë të ngushtë midis daljes në skenë të psikanalizës dhe shtrirjes mbresëlënëse të funksioneve të shkencës. Edhe pse mund të mos duket kështu menjëherë, ekziston një marrëdhënie bashkëkohësie midis çka është izoluar dhe kondensuar në fushën analitike dhe faktit që, kudo gjetiu, vetëm shkencës i ka mbetur ende diçka për të thënë.

Kjo, do të më thoni, është deklaratë shkenciste. Natyrisht që është, pse të mos jetë? Dhe megjithatë, nuk është vetëm ashtu, sepse unë nuk shtoj aty gjërat që i gjejmë gjithnjë në periferi të çfarë quajmë shkencizëm, ose një numër premisash të pranuara pa vërtetim, të cilat unë nuk i pranoj. Ekziston, për shembull, ideja se e gjithë kjo përfaqëson progres. Progres në emër të çfarë?

Këtë objeksion ma kanë bërë tani vonë, nga disa qarqe që e etiketojnë veten si psikanalitike. Duhet të them se më frymëzoi. Ma përcolli një zonjë e cila, më thonë, kishte mbajtur një leksion në lidhje me çfarë përfaqëson Lacan-i.

Tani, i jam mirënjohës kësaj, në thelb, që mund të zgjatem pak në këtë pikë. Nëse e kam kuptuar mirë, objeksioni në fjalë mund të formulohet kështu: 'Pse e shihni të nevojshme që të sillni në vështrim subjektin? A ka ndonjë gjurmë të subjektit te Freud-i?'

Kjo ishte goditje e hidhur, ju siguroj. Për fat të keq, me kalimin e kohës – një kohe të humbur për mua – nis dhe thellohet hendeku mes teje dhe efektit të kulturës, të gazetarisë. Tani që unë jam bërë person publik, kam nevojë për një ndërmjetës të më shpjegojë se çfarë u shkon në mend disave. Kështu, paska ca që kujtojnë se të sjellësh në vështrim subjektin në lidhje me Freud-in është diçka e re, një risi.

Në këtë pikë, unë po u flas, me sinqeritet, atyre që nuk janë psikanalistë – edhe pse nuk besoj se ka shumë psikanalistë këtu. Kushdo që e kupton sado pak se për çfarë po flasim, e di edhe se Freud-i flet për tre gjëra.

E para është që *Es*-i ëndërron. Pra është subjekt, apo jo. Çfarë po bëjmë këtu të gjithë? Nuk kam asnjë iluzion këtë: një auditor, madje edhe një auditor i kualifikuar, ëndërron teksa unë jap e marr. Gjithsekush mendon për punët e veta, për të dashurën që do të takojë



më vonë, për një bjellë që duhet zëvendësuar në motor të makinës, ose diçka tjetër që nuk shkon, diku.

Pastaj, *Es*-i ngatërrohet me këmbët e veta. Mendoni për shkarjet e gojës, lapsuset, gjërat që i bëjmë tjetër për tjetër, vetë tekstin e ekzistencës suaj. Këto e shndërrojnë në farsë groteske gjithçka që ju kanë mësuar, me të madhe, për funksionet ideale të vetëdijes dhe çka që implikon kjo për personin që kërkon të marrë kontroll. Unë nuk e di se ç'është kjo. Po të lexoni *Shkrimet*, do të shihni si kam mbetur gojëhapur kur kam lexuar gjërat që ka ëndërruar miku im i shtrenjtë Henri Ey, të cilin e dua shumë. Ai donte të qytetëronte psikiatrit, prandaj shpiku organo-dinamizmin, që është një katrahurë e vërtetë, pa kuptim fare. Unë sfidoj këdo që të gjejë ndonjë lidhje midis asaj me të cilën po merremi, tekstit të subjektit, dhe asaj që ka stisur ai për këtë të ashtuquajtur sintezë, ndërtimin e personalitetit, dhe nuk di çfarë tjetër. Ku janë vallë këto personalitete të ndërtuara? Unë nuk e di, edhe pse po i kërkoj me kandil në dorë, si Diogjeni. Më e bukura këtu është se, megjithë referimet e përsëritura

ndaj këtyre konstrukteve, *Es*-i faktikisht ngatërrohet me këmbët e veta. Kjo do të thotë diçka. Janë gjithnjë të tjerët, që ia dalin mbanë. Ka njerëz madje që u dorëzuan. Sa për mua, unë arrita të qëndroj.

Së treti, *Es*-i ëndërron, ngatërrohet dhe qesh. Tani, dua t'ju pyes, janë apo nuk janë subjektive këto tre gjëra? Ne duhet ta dimë se për çfarë flasim. Ata që vrasin mendjen se pse duhej ta sillja në vështrim subjektin kur po merreshim me Freud-in nuk e kanë idenë se për çfarë po flasin. Më duhet të nxjerr përfundimin se aty kanë ngecur, edhe pse kujtoja se rezistenca bazohej në diçka më të sofistikuar.

Subjekti për të cilin po flasim nuk ka të bëjë fare me çfarë quajmë subjektive në kuptim të pacaktuar, ose në kuptimin që përshtjellon gjithçka; as ka të bëjë gjë me individin. Subjekti është çfarë unë e përkufizoj, në kuptimin e ngushtë të fjalës, si një efekt të shënjuesit. Ky është subjekti, para se të gjejë vend, për shembull, në njërin ose tjetrin person si individ, madje edhe para se këta të ekzistonin si qenie të gjalla.



Natyrisht, mund të themi, në terma konvencionalë, 'Është subjekt i mirë ose i keq, është subjekt moral, është subjekt i njohjes', ose çfarëdo që t'ju pëlqejë tjetër. Kjo ide e një subjekti të njohjes është në fakt pa kuptim, dhe nuk e marr vesh pse vazhdojnë të flasin për të, në orën e filozofisë, në shkollë. Ajo mund të ketë vetëm këtë kuptim: që çdo gjallesë di aq, pikërisht aq sa i duhet për të mbijetuar. Por s'ka gjë tjetër që mund të themi për këtë. Mund ta shtrijmë në mbretërinë e kafshëve dhe – pse jo? – në atë të bimëve.

Sa për idenë e një lidhjeje midis njeriut dhe botës në kuptimin e pranuar të këtyre fjalëve, kjo do të thotë që ta shohësh atë botë si objekt dhe ta shndërrosh subjektin në një funksion korrelativ. Bota e menduar si *ob-jekt* parakupton një *sub-jekt*. Thelbi, ose substanca e kësaj marrëdhënieje nuk mund të jetë veçse një imazh madhështor soditjeje me natyrë haptazi mitike. Ne përfytyrojmë se ka pasur njerëz që soditnin botën. Tek Aristoteli gjen pa dyshim gjëra të tilla, për shembull kur ai flet për sferat, por kjo thjesht do të thotë se nuk ka teori të sferave qiellore që të mos kërkojë një lëvizje soditëse.

Ne e dimë çfarë është shkenca. Askush prej nesh nuk mund të zotërojë shkencën në tërësi. Ajo çan përpara me shpejtësi maksimale e shtyrë nga vrulli i vet, dhe ne s'bëjmë dot asgjë për ta ndryshuar këtë. Ata që janë në brendësi të punëve, janë edhe ata të cilëve u vjen më zor për këtë.

Çdo lloj përvoje e ndriçuar e mundshme tregon se subjekti varet nga zinxhiri i nyjëtuar që përfaqësohet nga njohja shkencore e fituar. Subjekti duhet të gjejë vendin e vet atje, të zërë vend sa më mirë që të mundet në mes të pasojave të atij zinxhiri. Ai duhet të rishikojë, pa pushim, të gjitha përfytyrimet e vogla intuitive që ka pasur dhe që bëhen pjesë e botës së tij, madje edhe të ashtuquajturat kategori intuitive. Atij gjithnjë i duhet t'ia bëjë ndonjë përmirësim aparatit, thjesht në mënyrë që të gjejë një vend për veten. Është për t'u çuditur që nuk është dëbuar nga sistemi deri më sot.

Dhe ky është, në fakt, synimi i sistemit. Me fjalë të tjera, sistemi dështon. Prandaj subjekti mbetet. Nëse diçka na jep përshtypjen se pikërisht aty mund të vëmë dorën, se aty gjendet subjekti, kjo ndodh vetëm në nivelin



e së pavetëdijshmes. Sepse e gjitha kjo ngatërrohet me veten, qesh dhe ëndërron.

*Es*-i ëndërron, ngatërrohet me veten dhe qesh në një mënyrë përsosmërisht të nyjëtuar. Çfarë bën Freud-i vazhdimisht gjatë qasjes së tij, gjetjes së tij, zbulimit që ia bën së pavetëdijshmes? Me çfarë e kalon kohën? Me çfarë merret? Pavarësisht nëse është fjala për tekstin e ëndrrës, për tekstin e batutës ose formën e lapsus-it, ai manipulon nyjëtime të gjuhës, të ligjërimit.

Në anë të një gravure të vogël të Goya-s, është shkruar: 'Gjumi i arsyes përfton përbindësha.' Kjo është thënë bukur dhe, meqë e ka thënë Goya, është edhe më e bukur – meqë mund t'i shohim përbindëshat.

Tani, kur ju flisni, gjithnjë duhet të dini se kur duhet të ndaloni. Të shtosh 'përfton përbindësha' tingëllon mirë, apo jo? Është fillimi i një deliri biologjik. Edhe biologjisë iu desh një kohë e gjatë që të bëhej shkencë. U humb shumë kohë duke vrarë mendjen për viçin me gjashtë thundra. Oh! Përbindëshat, pa shiko, pa shiko, imagjinata! Na pëlqen shumë imagjinata. Sa bukur. Siç e dini ju, ajo

e psikopatit është e mbushur, e nginjur me të tillë, na thonë psikiatrit. Ajo krijon dhe përfytyron gjëra. Është fantastike. Ata janë të vetmit që e përfytyrojnë këtë. Nuk ju them dot se si është puna me psikopatin – unë nuk jam psikopat aq sa duhet – por natyrisht nuk është siç thonë psikiatrit, sidomos kur këta flasin, ç'të them, për fiziologjinë e ndijimit, ose të perceptimit, dhe pastaj kalojnë në konstrukte dhe përgjithësime, në mënyrë që të provojnë të marrin me mend se kur do t'u ngecë sharra në gozhdë, të shkretëve. Kjo s'ka të bëjë fare me konstruktet e tyre. Kaq është e qartë, besoj.

Pra, duhet të dini kur të ndaleni. *Gjumi i arsyes* – kjo është e gjitha. Po çfarë do të thotë kjo? Do të thotë që arsyeja na nxit që të vazhdojmë të flemë. Edhe një herë, nuk di nëse ka ndonjë rrezik që ju ta kuptoni këtë deklaratë të vogël timen si irracionaliste. Jo, jo, krejt e kundërta. Çfarë do të donim ne që të hiqnim qafe, të përjashtonim, pra mbretëria e gjumit, e sheh veten të aneksuar nga arsyeja, nga sundimi i saj, funksioni i saj, nëpërmjet zgjedhës së ligjërimit, ose faktit që njeriu



banon në gjuhë, siç ka thënë tjetri. Është vallë irracionalizëm të vësh re, ose të ndjekësh linjën e të menduarit të arsyes brenda vetë tekstit të ëndrrës? Në fakt, psikanaliza mund të përfundojë e tëra, para se të ndodhë çfarë mund të ndodhë, ose kur të arrijmë pikën e zgjimit.

Freud-i ka shkruar diku: *Wo es war, soll Ich werden.* Edhe sikur të mbetemi në nivelin e topikës së tij të dytë, çfarë është kjo, në mos një mënyrë për të përkufizuar subjektin? Atje ku ishte mbretëria e gjumit, duhet të vij unë, ose të 'bëhem' në të ardhmen, në kuptimin e posaçëm që ka folja *werden* në gjermanishte. Çfarë do të thotë kjo? Që subjekti e banon tashmë nivelin e *Es*-it.

Nuk ka arsye pse të kapemi tani pas çikërrimave dhe të themi se, në topikën e tij të dytë, Freud-i e quan sistemin e perceptimit-vetëdijes *das Ich* (uni), duke përdorur nyjën shquese, meqë nuk ka fjalë në gjermanishte që të funksionojnë siç funksionojnë *moi* dhe *je* në frëngjishte. *Das Ich* është diçka si dy instancat e tjera, për ta thënë me një term të papërcaktuar mirë, me të cilat ai e shoqëron:

*Es*-i dhe *Überich*-u (mbiuni). Po çfarë është kjo, nëse nuk është, në kuptim të ngushtë, bërthama e subjektit?

Mund edhe të ketë lidhje me atë funksion grotesk, qesharak me të cilin luajtën të gjithë ata që ishin për një copë herë bashkudhëtarët e mi, që erdhën nga një Zot e di se ku, dhe të armatosur me psikologji, që nuk është se të përgatit për psikanalizë. E kam fjalën për funksionin e ndërsubjektivitetit. Ah! Lacan-i, 'Ligjërata e Romës', 'Funksioni dhe fusha e të folurit dhe gjuhës', ndërsubjektiviteti! je ti, jam edhe unë, dhe ne i themi gjëra njëri-tjetrit dhe i dërgojmë gjëra njëri-tjetrit, prandaj jemi ndërsubjektivë. Mirëpo e gjithë kjo është shumë pështjelluese.

Besoj se ju e dini pozicionin tim për këtë çështje, por, nëse nuk e dini, unë mund t'ua shpjegoj tani më mirë. Të ngatërrosh subjektin me mesazhin është një nga karakteristikat e të gjitha budallallëqeve që janë thënë për të ashtuquajturin reduktim të gjuhës në komunikim. Funksioni komunikativ nuk ka qenë kurrë aspekti më i rëndësishëm i gjuhës. Kjo ishte pikënisja ime.



Von Frisch mendon se bletët kanë gjuhën e tyre, sepse ato i komunikojnë gjëra njëra-tjetrës. Të tilla gjëra thonë njerëzit herë pas here, kur e lënë veten në flatrat e imagjinatës: dhe pikërisht, fakti që diçka mbërrin tek ne prej yjeve provon se ne marrim mesazhe prej tyre. Po në ç'kuptim është 'mesazh' kjo? Nëse i japim një kuptim fjalës 'mesazh', atëherë duhet të ketë një dallim midis këtij dhe një transmetimi çfarëdo. Po të mos kishte dallim, gjithçka në botë do të ishte mesazh. Dhe veç kësaj, ka një kuptim në të cilin gjithçka është mesazh, po të shohësh sa të modës janë bërë funksionet e transmetimit dhe përcjelljes së informacionit, siç thonë. Nuk është e vështirë të shohësh se ky informacion mund të formalizohet në mënyrë të tillë sa të paraqitet si e kundërta e shënjimit. Kjo në vetvete mjafton për të treguar se informacioni, i marrë në atë kuptim, nuk duhet ngatërruar me rezultatin e çfarë vihet në lojë kur përdorim gjuhën.

Nyjëtimi i gjuhës shtron, para së gjithash, çështjen e subjektit të thëniezimit. Subjekti i thëniezimit kurrsesi nuk duhet ngatërruar me atë që përfiton nga rasti për ta quajtur

veten *unë*, si subjekt i thënies. Kur këtij i duhet të flasë për veten, ai e quan veten *unë*. Kjo thjesht do të thotë *unë që po flas*. Përemri *Unë* që shfaqet në një thënie çfarëdo nuk është asgjë më tepër se një *shifter*, siç e quajnë gramatikanët. Gjuhëtarët thonë se ky qenka edhe subjekt i thëniezimit. Mirëpo e kanë gabim, pa le se ç'thonë. E kanë kaq gabim, sa këtë e kemi kuptuar qëkur jemi njohur me të. Ti gjithnjë mund të provosh ta gjesh subjektin e disa thëniezimeve. Por këtë nuk mund t'ia atribuosh kujtdo që mund të thotë *unë*.

Kjo do të thotë, gjithsesi, se ne duhet ta rindërtojmë pakëz të ashtuquajturën skemë të komunikimit. Nëse ka një gjë që duhet vënë në dyshim, kjo është funksioni i thjeshtë i ndërsubjektivitetit, i cili supozon një marrëdhënie të thjeshtë të dyanshme midis një dhënësi dhe një marrësi, që funksionon vetvetiu. Po nuk është fare kështu.

E para gjë që lidhet me komunikimin, është të dish se çfarë do të thotë kjo. Të gjithë e dinë këtë. Ty s'të duhet ndonjë eksperiencë e madhe, që të tregosh se çfarë është duke thënë tjetri asnjëherë nuk përkon me çfarë thotë.



Kjo shpjegon edhe pse ti thyhesh më dysh, duke u munduar të ndërtosh një logjikë për këtë. Në mënyrë që të mos mbetet asnjë dyshim për shenjat e vogla që mund të vësh në tabelë. Pikërisht: ti po rrekesh ta eliminosh subjektin. Dhe pasi të kesh vënë aty ca shkronja të vogla, subjekti vërtet eliminohet, për një çast. Natyrisht, ti do ta gjesh subjektin prapë, kur të arrish fundin, në formën e gjithfarë paradokseve. Përpjekjet e logjikës për t'i studiuar gjërat nga afër janë gjithnjë instruktive dhe mahnitëse.

Ndonjëri do të objektojë se, nëse duam të flasim për diçka që është absolutisht jo psikike, por që është një metapsikologji reale, ose, me fjalë të tjera, diçka shumë e ndryshme nga psikologjia, duhet të flasim për *Es*-in, Unin, ose Mbiunin. Ne sillemi sikur të gjitha këto të ishin të natyrshme, të padiskutueshme, të vetvetishme, si diçka që mund ta shihnim që prej një kilometri larg. Por nuk është kështu fare. Jo vetëm kjo ndryshon nga avazi i vjetër; por nëse ka diçka që mund ta quajmë, legjitimisht, ndërsubjektivitet, një ndërsubjektivitet që nuk është thjesht dramatik, por edhe tragjik,

atëherë ky nuk do të ketë fare të bëjë me rendin e komunikimit, me një ndërsubjektivitet të njerëzve që shtyhen, shtypen e përplasen me njëri-tjetrin dhe ia marrin frymën njëri-tjetrit – dhe kjo merr formën e *Es*-it, të Unit dhe të Mbiunit dhe nuk e ka fare problem që të bëjë pa atë që ju do ta quanit subjekt tërësor.

Më pyesin se pse flas për subjektin, pse ia shtokam atë Freud-it. Mirëpo te Freud-i vetëm për subjekt flitet. Dhe flitet në një mënyrë brutale, urdhëruese. Është si punë buldozeri, dhe sjell në jetë gjithçka që të tjerët janë munduar ta mbajnë të fshehtë për subjektin për mijëra vjet tradite filozofike.

Siç po ju thosha pak më parë, është pikërisht në këtë rend të sendeve, që po përpiqen të turbullojnë ujërat. Çfarë kam theksuar unë, dhe unë nuk mund të pretendoj se kam qenë duke bërë ndonjë gjë më shumë se të sugjeroj një përmasë këtu, e ka një kundërpeshë, të cilën na e japin filozofët. Është njëri, për shembull, për të cilin bëj një aluzion të shkurtër në numrin e parë të revistës sime *Scilicet*, një djalë shumë i talentuar i cili po i ruan ca surpriza në mëngë për ne, kur të vijë puna për tema të



mëdha klasike, dhe unë kisha dëgjuar për këto shumë kohë para se ta takoja në një kongres. Dhe ai më thotë: 'Ju keni shumë të drejtë, unë pajtohem me çfarë thoni,' dhe në fakt dukej qartë që pajtohej, sepse në artikullin e vet për Freud-in nuk shkroi asgjë që nuk e kisha thënë unë më parë – 'Por pse, pse, pse ngulni këmbë për ta quajtur subjekt xhanëm?'

Ja, kështu ndodh kur prek ca tema, dhe zbulon që dikush i ka 'zënë' para teje. Një person që tani po e nxjerr këtë mësim, guxoi të shkruante një herë një libër për Racine-in. Mirëpo problemi ishte se ai nuk ishte i vetmi, meqë ishte edhe një tjetër që kujtonte se ishte ekspert për Racine-in. Si guxon ky? Etj. Në këtë rast, filozofi ishte përgatitur të më thoshte: 'Pse vazhdoni ta quani subjekt të pavetëdijshmen – ose pikërisht atë të pavetëdijshme që ju thoni është e strukturuar si gjuhë?'

Kur analistët më bëjnë pyetje si kjo, unë shokohem, por nuk mund të them se habitem. Mirëpo kur pyetje të tilla më vijnë prej filozofëve, ato janë kaq shqetësuese, sa unë nuk gjej dot përgjigje tjetër, përveçse t'u them: 'Unë e mbaj subjektin... që t'ju bëj të flisni.'

Dhe megjithatë, do të ishte marrëzi të mos rimerrej termi. Një aksident i lumtur në traditën filozofike e ruajti linjën e nisur me *Organon*-in e Aristotelit, për të cilin po flisja pak më parë. Lexoni, ose rilexoni *Kategoritë*, miqtë e mi, ose të paktën ata prej jush që kujtohen ndonjëherë të lexojnë ndonjë tjetër veç teksteve mësimore, dhe do të shihni që në krye ndryshimin mes subjektit dhe lëndës.

Kjo është kaq e rëndësishme, sa dy mijë vjet traditë filozofike, për të cilën po flisja, janë përpjekur veç ta reduktojnë. Hegeli, që konsiderohet si kulmi i traditës filozofike, sugjeron me – duhet ta them – mendjemprehtësi mahnitëse, diçka që e mohon atë së cilës i afrohemi në ëndrrat, dhe pikërisht se lënda është tashmë subjekti, para se të bëhet subjekti, siç e pamë edhe ne, me formulën e Freud-it.

E gjithë kjo nis me traumën fillestare të pohimit të Aristotelit, e cila solli ndarjen më të prerë midis subjektit dhe substancës. Kjo është harruar tani krejt.

Që subjekti i ka mbijetuar traditës filozofike, kjo tregon, nëse mund të shprehemi kështu, se ne në fakt mendimi ka dështuar.



Po vallë a nuk është kjo arsye për të mos e braktisur termin 'subjekt', tani që ka ardhur më në fund koha për t'ia përmbysur vlerën e përdorimit?

*Pra, do të keni*
*dëgjuar Lacan-in*

Nuk them dot që barra ime është shumë e vështirë. Përkundrazi, është ëe e lehtë. Vetë mënyra si më prezantuan tregon se, gjithsesi, do të kem folur si Lacan-i.

Pra, do të keni dëgjuar Lacan-in.

'Leksioni' nuk është i stilit tim. Nuk është i stilit tim sepse çdo javë, gjatë 15 vjetëve të fundit, unë kam dhënë diçka që nuk është konferencë, por çfarë e quanin një herë seminar, në kohët kur kishte akoma njëfarë entuziazmi për këtë, dhe që është një orë mësimi dhe, gjithsesi, një seminar, ende ashtu quhet.

Këtë nuk do t'jua dëshmoj unë, por ata pak që kanë qenë aty që në krye, disa duke zëvendësuar të tjerë: asnjë nga ato orë mësimi nuk është përsëritur ndonjëherë.

Pati një moment, gjatë kësaj periudhe, kur unë mendova se u detyrohesha atyre pakëve

që kisha përreth, që t'u shpjegoja diçka, diçka me të cilën do të merremi tani. Dhe, për atë Zot, kjo diçka duhet të ketë qenë vërtet e vëllimshme për mua, që nuk e kam mbaruar ende së shpjeguari.

Është e çuditshme. Ndoshta kjo vjen edhe ngaqë vetë zhvillimi i çfarë kam pasur për të shpjeguar më shkaktoi mua probleme dhe ngriti çështje të reja. Ndoshta. Por nuk është e sigurt.

Sidoqoftë, unë nuk pretendoj aspak që t'i përshkruaj qoftë edhe vetëm devijimet e saj kryesore sot, madje edhe vetëm nëpërmjet aluzioneve, drejtuar atyre që e dinë se për çfarë jam duke folur dhe që edhe e kanë një farë ideje se çfarë kam thënë për këtë më parë.

Sa për pjesën tjetër prej jush, që jeni mbledhur këtu por që nuk dini asgjë ose dini vetëm shumë pak për sa më lart, as që shtrohet çështja që t'ju jap ndonjë ide për të, meqë çfarë thashë tani është e vërtetë, unë s'e kam përsëritur ndonjëherë veten.

Në fakt, zhanri i 'konferencës' parakupton një postulat që është thelbësor për vetë emrin e 'universitetit': ekziston një gjë e tillë



si universi, me çka unë kuptoj një univers ligjërimi. Ligjërimi, dua të them, ka arritur gjatë shekujve të përftojë një rend që është stabilizuar deri në atë shkallë sa gjithçka të parcelizohet, të ndahet në sektorë të cilët ne duhet t'i studiojmë veçmas dhe me kujdes, në mënyrë të tillë që gjithkush të japë kontributin e vet të vogël në një mozaik, konturet e të cilit janë përcaktuar tashmë, sepse puna me to konsiderohet si e mjaftueshme.

Mirëpo mjafton një vështrim i shpejtë në histori, për ta hedhur poshtë idenë se shtresat e hedhura gjatë historisë, dhe të përpunuara shekull pas shekulli, përbëjnë vlera që ngrihen mbi njëra-tjetrën dhe që mund të bashkohen për të krijuar universitetin – Universitetin e Letrave, ose *Universitas litterarum*, që është themelor për mësimin përkatës.

Vetëm kujdes, ju lutem, mos e merrni këtu fjalën 'histori' në kuptimin që jua kanë mësuar, siç shfaqet në termin 'historia e filozofisë', ose historia e gjithçkaje tjetër, sepse ai farë risuvatimi ka për qëllim t'ju marrë sytë e t'ju bëjë të mendoni se stadet e ndryshme të mendimit përftojnë njëri-tjetrin. Mirëpo

mjafton t'i hidhni një sy historisë, për të parë se nuk është fare kështu, dhe se gjithçka e ka zanafillën në thyerjet, në një njëpasnjëshmëri orvatjesh dhe hapjesh të cilat, në çdo stad, na kanë prishur mendjen dhe na kanë bërë të mendojmë se mund ta rroknim tërësinë.

Si rezultat i kësaj, po të shkoni tani te një librashitës, te një dyqan librash antikuarë, dhe të merrni një libër çfarëdo nga periudha e Rilindjes, ta hapni e ta lexoni siç duhet, do të shihni se nuk do të jeni në gjendje të ndiqni fillin e mendimit për tre çerekun e gjërave që i shqetësonin ata njerëz atëbotë dhe që u dukeshin thelbësore. Nga ana tjetër, çfarë mund t'ju duket juve e natyrshme, erdhi në ekzistencë gjatë një farë epoke – jo njëzet, tridhjetë ose pesëdhjetë vjet më parë, por gjithsesi jo më herët se Descartes-i.

Ishte që me Descartes-in që disa gjëra filluan të ngjasin, gjëra që ia vlen të vihen në dukje, sidomos përurimi i shkencës sonë moderne, një shkencë që, si tipar dallues, ka efektshmërinë me të cilën arrin të ndërhyjë në detajet më të përditshme të jetës së gjithkujt prej nesh. Ndoshta pikërisht kjo karakteristikë



e dallon nga sistemet e mëparshme të dijes, të cilat gjithnjë ishin praktika më ezoterike, me çka dua të them se ishin menduar si privilegj i një numri të paktë njerëzish.

Sa për ne, ne jemi të rrethuar me zbulimet e kësaj shkence. Edhe sendet më të zakonshme këtu, edhe këto karrige të vogla ku jeni ulur ju, janë në fakt produkt i saj. Një herë e një kohë, karriget i bënin me katër këmbë, si kafshët; karriget duhej të ngjanin si kafshë. Sot duken pak si mekanike. Dhe doemos, ju ende nuk jeni mësuar me to, ju merr malli për karriget e vjetra.

Pra, çfarë ju mësoj unë, lidhet me diçka që lindi në një moment historik dhe në shekujt kur ishim të zhytur, deri në grykë, në kontekstin e shkencës, madje edhe para se të mund ta thoshim këtë siç e them unë tani. E kam fjalën për psikanalizën.

Më kanë detyruar ta vë veten në një pozicion shumë të veçantë, si mësues, meqë pozicioni im konsiston në atë që unë duhet të filloj sërish, në një pikë të caktuar, në një fushë të caktuar, thuase asgjë nuk është bërë aty. Kjo është domethënia e psikanalizës.

Kjo, sepse asgjë nuk është arritur brenda një fushe të caktuar klasike, të njohur deri më sot si 'psikologji', e cila, nga ana e vet, mund të shpjegohet, natyrisht, me të gjitha rrethanat historike në të shkuarën. Çfarë dua të them, është se, megjithëse ishte ndërtuar një konstrukt shumë elegant, që u shërbeu disa qëllimeve, në bazë të një numri të caktuar postulatesh themelore, fakti është që këto postulate gjithnjë u desh të rindërtoheshin retroaktivisht. Nëse i pranojmë këto postulate, çdo gjë është në rregull, por nëse disa aspekte të tyre vihen në dyshim në mënyrë rrënjësore, atëherë asnjë nuk funksionon më.

Mësimi im nuk i shërben atij qëllimi, por i është nënshtruar atij. Shërben për të promovuar diçka që ka ndodhur tashmë, dhe kjo diçka e ka një emër: Freud.

Ngjan ndonjëherë që gjërat që kanë ndodhur të kenë emër. Kjo përbën problem në vetvete, dhe natyrisht nuk mund të zgjidhet me anë nocionesh si ato që i quajmë ndikime, huazime, lëndë. Në shumë raste, është mirë të dihet se cilat janë burimet. Është mirë, për shembull, në nivelin letrar, nga pikëpamja



e *Universitas litterarum* dhe brenda kësaj perspektive. Por kjo nuk zgjidh asgjë, kur ndodh që diçka të shfaqet papritur – një poet i madh, për shembull. Të përpiqesh t'i qasesh problemit nëpërmjet burimeve është marrëzi e kulluar.

Pikëpamja e 'burimeve' mund të përdoret edhe në praktikën mësimore të përditshme, ose në zhanrin që sapo e quajta të 'leksioneve'. I vetmi problem është se, herë pas here, ndodhin thyerje, shkëputje, dhe se disa njerëz në fakt kanë qenë në gjendje të huazojnë gjëra të vogla, aty-këtu, për të ushqyer ligjëratën e tyre, edhe pse thelbi i ligjëratës së tyre e ka pikënisjen te thyerja.

Nëse mësimi im shërben për të promovuar Freud-in dhe e shpall hapur se është në shërbim të tij, atëherë ç'kuptim kanë burimet? Kuptimi i burimeve është, në këtë rast, se çfarë më intereson mua nuk është që ta reduktoj Freud-in në burimet e tij.

Përkundrazi, unë do të tregoj funksionin që atij i shërbeu si shkëputje. Kur është fjala për ta futur atë në rresht, për ta kthyer në vendin e vet brenda psikologjisë së përgjithshme, këtë

ka të tjerë që po përpiqen ta bëjnë, dhe në mundim e sipër këtyre u shpëton e vetmja gjë me interes, dhe pikërisht pse emrit të Freud-it i bashkëlidhet ajo gjë tepër e veçantë, që ia jep atij emri vendin që ka në vetëdijen e epokës sonë.

Tek e fundit, pse vallë ka emri i Freud-it një prestigj të ngjashëm me atë të Marx-it, edhe pse nuk ka pasur ndonjëherë, deri më sot, ndonjë prej efekteve kataklizmike të këtij të fundit? Pse xhanëm? Pse ekziston një fushë e tërë ku ne nuk mund të bëjmë gjë tjetër, veçse ta evokojmë, dhe ku ka marrë vlerën e një pike nodale – pavarësisht nga nëse pajtohemi me çfarë ka thënë dhe cili na duket se është mesazhi i tij, pa qenë në gjendje të themi se çfarë do të thotë pikërisht, përveçse që është një lloj mitologjie që ka hyrë në qarkullim? Si shpjegohet që ky emër është kaq i pranishëm në vetëdijen tonë?

Që unë po përpiqem kështu të lëvdoj Freud-in, është diçka krejt e ndryshme nga çfarë do t'i quaja fitoret e mendimtarëve. Natyrisht, nuk është se nuk ka lidhje me mendimin, por është diçka që na ndihmon të kuptojmë më



mirë efektet e mendimit në historinë tonë të përbashkët.

Juve mund t'ju shkojë mendja se, meqë barra e mesazhit të Freud-it hë për hë u ka mbetur mjekëve mbi supe, mund të thuhet se, tek e fundit, ai është më pak i rëndësishëm se gjërat konkrete me të cilat merren mjekët, dhe me fjalën 'konkrete' unë kam parasysh çfarë bëjnë ata me pacientët e tyre, të cilët i trajtojnë thjesht si sende që duhen trajtuar, si diçka që reziston.

Freud-i na mësoi se disa prej këtyre të sëmurëve janë të sëmurë të mendimit [*malades de la pensée*]. I vetmi problem, është se duhet t'i kushtojmë vëmendje atij funksioni që është emërtuar kështu. A janë këta të sëmurë në kuptimin se 'kanë një dërrasë mangut', pra se gjithçka po u ndodh në nivelin e të menduarit? A është kjo domethënia?

Kjo, në thelb, është çfarë thuhej para Freud-it. Në fakt, ky është problemi vetë. Flitet për 'psikopatologji mendore'. Ka disa kate brenda organizmit dhe njëri prej tyre është kati i sipërm. Diku, në nivelin e komandës, ka një tip që rri në një dhomë të vogël lart

ai nuk dëshiron ta përfytyrojë veten me çdo kusht. Pa dyshim, më parë mund të heqë dorë nga vetja, sesa të mendohet; për këtë nuk ka asnjë dyshim. Madje as dëshiron fare që të pranojë nxitje që mund të vijnë nga jashtë, për ta bërë ta rrokë veten si mendim. Ja çfarë na mëson zbulimi i së pavetëdijshmes.

Ky zbulim ndodhi në një kohë kur asgjë nuk ishte më e mbyllur ndaj sfidave, sesa epërsia e të menduarit. Veçanërisht ata njerëz të cilët i quanin, në disa qarqe, si pasardhësit fisnikë dhe të qytetëruar të grekëve dhe të romakëve e shihnin veten si njerëz që, më në fund, kishin arritur fazën e mendimit pozitiv dhe e shihnin me besim të tepruar – siç e tregoi edhe historia – progresin e mendjes njerëzore dhe faktin se, në disa zona, ti mund të kapërceje gardhin dhe të futeshe, me pak ndihmë, me pak të shtyrë, në rrethin e atyre njerëzve që mund ta quanin veten të ndriçuar.

Freud-i pati meritën që e vuri re se duhej t'i këqyrnim këto gjëra ndryshe, shumë më parë se historia të na kujtonte që duhej të ishim më modestë. Historia na ka treguar, siç kemi mundur pastaj ta rrokim në tërësi,



se nuk ekziston asnjë lloj fushe e privilegjuar brenda dijes, e cila mund të përkufizohet si e njerëzve që kanë aftësi të veçantë për të trajtuar gjuhën. Pavarësisht nëse janë të qytetëruar apo jo, njerëzit janë të aftë për të njëjtat lloje entuziazmi kolektiv, të njëjtat dalldi. Ata kanë mbetur gjithnjë në një nivel të cilin nuk ka arsye ta përshkruash si më të lartë apo më të ulët, si afektiv, pasionant apo gjoja intelektual ose të zhvilluar, siç e quajnë. Ata kanë të njëjtat mundësi për të zgjedhur dhe për të arritur të njëjtat suksese, ose të njëjtat rravgime.

Megjithë dëmtimet që ka pësuar, duke u kaluar dorë më dorë nga njerëz që mbahen si përfaqësuesit e tij zyrtarë, mesazhi i Freud-it nuk bie në kundërshtim me çfarë na ka ndodhur neve që nga koha e tij, dhe kjo duhet të na frymëzojë të përqafojmë një pikëpamje shumë më modeste, për mundësinë e progresit në të menduar.

Freud-i nuk është aspak kontradiktor; ai mbetet aty, me mesazhin e vet, dhe efekti i këtij mesazhi veç forcohet nga fakti që ai është ende në gjendjen e vet më solide dhe më enigmatike, edhe pse kanë arritur ta mbajnë mbi ujë, duke

e vulgarizuar deri diku. Në nivelin ku qenia njerëzore është një mendim i cili, fatmirësisht, përmban në vete një paralajmërim sekret për të cilin nuk është i vetëdijshëm, njerëzit e ndiejnë se në mesazhin e Freud-it, madje edhe në formën me të cilën ky mesazh qarkullon sot, tani që është shndërruar në pilula, ka diçka të vyer edhe pse të alienuar – por ne e dimë se jemi të lidhur pas këtij alienimi; meqë është alienimi ynë.

Kushdo që merr mundimin të përpiqet të arrijë nivelin ku ky mesazh e ka një farë efekti do të ngjallë interes - dhe këtë e kanë sqaruar tashmë, madje edhe unë, në atë përmbledhje mbeturinash që njihet si *Shkrime* – do të ngjallë interes, pra, për një larmi të madhe njerëzish, nga më të ndryshmit, nga më të shumëllojshmit; me një fjalë, për gjithkënd.

Kjo do t'i habitë të gjithë ata që këmbëngulin se letërsia gjithnjë duhet t'u përgjigjet disa nevojave. Këta që habiten se pse libri im *Shkrime* po shitet mirë. Unë jam njeri i sjellshëm, prandaj kur më vjen ndonjë gazetar dhe ma bën këtë pyetje, unë e vë veten në vendin e tij dhe i them: 'As unë nuk e di.'



Pastaj i kujtoj se ky libër nuk është veçse një përmbledhje fijesh, sendesh të mbiujshme, ishujsh dhe shenjash referimi, që unë i mbaj shënim për nxënësit e mi. Pilulën e kam hequr mënjanë, në një vend të sigurt, në mënyrë që ta mbajnë mend se çfarë kam thënë, në çfarë date, etj.

Mirëpo *Shkrimet* i interesojnë gazetarit, në fund të fundit, dhe ai më thotë se njerëzit po i lexojnë. Ndoshta u interesojnë kaq shumë njerëzve, për shkak të çfarë kam thënë aty. Mirëpo kjo të habit, po ta shohësh në nivelin e 'nevojave', nevojave konkrete; nivel i cili qëndron pas gjithë reklamës. Pse duhet t'i duhen njeriu këto *Shkrime*, në qoftë se janë kaq të pakuptueshme? Ndoshta njerëzit kanë nevojë për një vend ku të shohin se po flitet për diçka që nuk e kuptojnë. Pse jo?

Edhe pse synimi i mësimit tim është të promovoj Freud-in, unë nuk e bëj këtë në nivelin e publikut të gjerë. Publiku i gjerë nuk ka nevojë për fjalën time, që ta vlerësojë Freud-in. Mjafton çfarë po bëjnë të tjerët, miqtë e mi. Siç ua kam shpjeguar tashmë, çfarëdo që bëjmë ne, madje edhe sikur t'ua kalojmë

përgjegjësinë tarafit të psikanalistëve – dhe unë jam një nga kryesorët aty – Freud-in s'e lëviz njeri.

Deri më sot, përpjekjet e mia mësimore nuk është se e kanë lartësuar Freud-in në nivelin e shtypit popullor. Për këtë nuk do të kishte nevojë, dhe në fakt unë nuk shoh pse duhej të isha shqetësuar unë për këtë, apo të kisha marrë mundimin, sikur kjo të mos ishte e destinuar për psikanalistët.

Kjo është çfarë keni prej meje, në formulën e vet më të gjerë.

Unë vërtet duhet të përqafoj pikëpamjen sipas së cilës mendimi ekziston në nivelin më radikal dhe që andej kushtëzon së paku një pjesë të madhe të çka ne përndryshe e njohim si kafsha njerëzore.

Çfarë është të menduarit? Përgjigja nuk gjendet në nivelin ku kujtohet se thelbi i të menduarit është të jetë i tejdukshëm kundrejt vetvetes dhe ta njohë vetveten si mendim. Më tepër gjendet në nivelin e faktit që çdo qenie njerëzore lindet e zhytur në diçka që e quajmë të menduar, por hulumtimet e mëtejshme, që nga vepra më e hershme e Freud-it e këtej, tregojnë, natyrisht, se është praktikisht e



pamundur të kuptohet çfarë është, në qoftë se nuk mbështetemi në materialin e tij, që konsiston në gjuhën, në krejt misterin e saj.

Them 'misterin', meqë origjina e gjuhës nuk është ndriçuar; përndryshe, diçka mund të thuhet, pa dyshim, për kushtet e saj, aparatin e saj, dhe mënyrën si është ndërtuar, në nivelin minimal të çka e quajmë struktura e saj.

Të mohosh se Freud-i u nis që andej, është të mohosh diçka të vetëkuptueshme, të mohosh çfarë duket sheshit që në veprat e tij të para të rëndësishme, sidomos *Traumdeutung*, *Psikopatologjia e jetës së përditshme* dhe *Witz*, të cilën e kemi përkthyer si *Batutat* [fr. *Le Mot d'esprit*]. Freud-i në krye e cilëson fushën e së pavetëdijshmes në ato dukuri të cilat duken si irracionale dhe kapricioze: ëndrrat janë absurde, lapsuset janë qesharake dhe *Witz*-et që na bëjnë për të qeshur pa e kuptuar as ne pse.

Më duhet t'i bie shkurt.

Edhe pse Freud-i na shpjegon se seksualiteti është veçanërisht i implikuar me këto dukuri, fakti mbetet se struktura dhe materiali në fjalë cilësojnë të pavetëdijshmen, meqë e gjithë

kjo ndodh pa asnjë farë ndihme nga çfarë e konsideronim, deri në atë kohë, si mendim, ose si diçka që ishte në gjendje të përfytyronte vetveten si të vetëdijshme. Kjo është, në fakt, pikënisja e Freud-it dhe përmbysja që sjell ai.

Dhe kjo ngre disa çështje krejt të reja.

Çështja e parë është nëse vetëdija vetë është apo jo ajo gjë që pretendon të jetë ndoshta më e parrokshmja, por pa dyshim më autonomja nga të gjitha, dhe nëse e pavetëdijshmja mund të jetë thjesht një pasojë, një hollësi – dhe një hollësi që sillet si mirazh – në krahasim me çfarë përcaktohet prej efekteve të një farë nyjëtimi rrënjësor, një nyjëtimi të cilin e rrokim në gjuhë, në atë masë që ndoshta përfton atë që e quajmë mendim.

Të menduarit, me fjalë të tjera, nuk duhet konceptuar si një lloj luleje që çel në krye të këtij apo atij evolucioni; dhe është e vështirë, tek e fundit, të gjesh faktorin e përbashkët që përcakton, tek e fundit, përftimin e kësaj luleje. Detyra jonë është të hulumtojmë, seriozisht, origjinën e tij.

Të menduarit pa dyshim nuk na shfaqet, të paktën hë për hë, në formën e një funksioni që



mund të përshkruhet si më i lartë, në çfarëdo mënyre. Përkundrazi, është një parakusht mbi të cilin vendosim, sa më mirë që të mundemi, një mori funksionesh shtazore, nga ato më të lartat, ato që mund të lokalizohen në nivelin e sistemit nervor qendror, tek ato që ndodhin në nivelin e barkut dhe të rropullive dhe që, kushedi pse, mbahen si më të ulëta.

Çfarë ngre peshë këtu, me fjalë të tjera, është të vësh në diskutim këtë tarracim entitetesh i cili priret të na bëjë t'i kuptojmë mekanizmat organikë në terma hierarkikë, edhe pse ata ndoshta është më mirë të shpjegohen në nivelin e një kontradikte rrënjësore midis tre regjistrave, që unë i kam quajtur si Simbolik, Imagjinar dhe Real. Madje edhe distancat e tyre të ndërsjella nuk janë homogjene. Thjesht t'i vësh ato në të njëjtën listë është pak arbitrare në vetvete. Po ç'rëndësi ka kjo, nëse këta regjistra arrijnë ta prezantojnë çështjen me një farë efikasiteti?

Gjithsesi, sapo që merremi me nivelin e një pasioni ose vuajtjeje të caktuar, sapo që merremi me të menduarit – dhe askund nuk e rrokim dot atë që mendon si vetëdije –

me të menduarit që nuk e rrok dot vetveten asgjëkund, të menduarit për të cilin gjithnjë mund të pyetet se kush po e mendon, kaq mjafton për ta bërë këdo që futet në këtë dialektikë të çuditshme të heqë dorë, së paku sa i përket atij, nga mbizotërimi i të menduarit, në atë masë që ky është në gjendje të rrokë vetveten.

Kjo do të thotë se nuk mjafton që psikanalisti ta ketë lexuar Freud-in deri në një farë shkalle, duke mbajtur parasysh ato çështjet e vogla të universit psikologjik, që e bëjnë të qartë që në krye se 'ti je ti dhe unë jam unë'; dhe, sa për mua, si psikanalist që jam, m'u dashka t'ju ndriçoj rrugën përmes labirintit të këtij saraji të cilin, pas gjase,e njoh mirë prej kohësh.

Në nivelin e praktikës së vet, psikanalisti duhet gjithnjë të jetë në gjendje ta prezantojë veten si dikush që e di sa shumë varet nga gjëra, që, në parim, duhej t'i kish rrokur tërësisht gjatë përvojës së tij fillestare; si, për shembull, varësia e tij nga një fantazmatikë e caktuar. Në parim, psikanalisti mund ta arrijë këtë. Ai nuk duhet të mendojë se di, thjesht ngaqë ata që vijnë ta takojnë, e bëjnë këtë ngaqë atij



i mvishet statusi që e kam quajtur *subjekti i hamendësuar me dije*. Ata nuk kështillohen me të për çfarë ka të bëjë me ndonjë dije, qoftë edhe për subjektin ose dije të përgjithshme, por për çfarë i shpëton dijes dhe, sidomos, për diçka që gjithsekush prej tyre refuzon që ta dijë.

Po pse të mos dojë të dijë, në mos për tjetër gjë, së paku ngaqë kjo mosdije e vë në pikëpyetje si subjekt të dijes? Kjo vlen edhe në nivelin e qenies më të thjeshtë dhe, le ta themi, më pak të informuar.

Analisti nuk beson se ai mund ta futë veten në këtë çështje thjesht duke pranuar rolin që i ka rënë për hise, në formën e *subjektit të hamendësuar me dije*. Ai e di fare mirë se nuk di, dhe se ka një rrezik që, çfarëdo që ai të ndërtojë si dijen e vet do të përftohet si asgjë më tepër sesa mbrojtje ndaj së vërtetës së atij vetë.

Gjithçka që ai mund të ndërtojë për psikologjinë e obsesivit, gjithçka që ai mund të trupëzojë në të ashtuquajturën prirje primitive, nuk do ta pengojë atë dot, kur marrëdhënia transferenciale të shkojë disi më tutje, që

të merret në pyetje në regjimin themelor të neurozës, sa kohë që ai përfshin lojën e ndërsjelltë dhe rrëshqitëse midis kërkesës dhe dëshirës. Asgjë nuk mund të zhvendoset, gjatë një praktike, nëse psikanalisti nuk e ndien, vërtet, se kërkesa histerike interesohet pikërisht për dëshirën e analistit dhe se ndërsa dëshira e obsesivit është që ta ndezë me çdo kusht kërkesën e tij.

Por nuk mjafton, për të, që t'i përgjigjet asaj thirrjeje duke i provuar, gjithsekujt prej atyre që e pyesin, se këto forma të adoptuara prej nesh janë përcjellë dhe riprodhuar në pajtim me ligjin që rregullon marrëdhëniet e gjithkujt me partnerin e vet. Nuk mjafton për të që ta zhvendosë pyetjen drejt një përsëritjeje çfarëdo, e cila do të jetë gjithnjë retroaktive. Kjo përmasë është pa dyshim thelbësore, që subjektit i duhet bërë të kuptojë atë pjesë të tij që e ka humbur, në formën e një thelbi të pareduktueshëm. Mirëpo pa ndonjë skelet ndihmës, të gjitha konstruktet e shumta, të ndërlikuara që kanë për synim të shpjegojnë rezistencat, mbrojtjet dhe operacionet e subjektit, këtë apo atë arritje më shumë a më



pak të dëshiruar, nuk mund të përfaqësojnë gjë tjetër, përveçse superstruktura, në kuptimin e konstrukteve fiktive.

Synimi i këtyre konstrukteve është thjesht ta ndajnë analizën nga vendi ku, në analizë të fundit, kjo po gjurmohet. Me fjalë të tjera, ato duan të përfaqësojnë – për subjektin – diçka prej së cilës progresi i analizës duhet ta bëjë të heqë dorë, dhe pikërisht objektin, i cili është njëkohësisht objekt i privilegjuar dhe objekt-mbetje, të cilit ai vetë i është ngjitur. Ky pozicion është dramatik, sepse, në fund të procesit analitik, analisti duhet të dijë si ta mënjanojë veten nga ky dialog si diçka që shkëputet dhe bie prej tij, dhe bie prej tij përgjithmonë.

Disiplina që i duhet të ndjekë është, për këtë arsye, e kundërt me disiplinën që kërkohet prej një autoriteti të dijes. Nuk e kam fjalën për disiplinën e dijetarit [*savant*]. Shkencëtari, i shkencës moderne, vendos, në fakt, një marrëdhënie të veçantë me sipërfaqen e tij sociale dhe dinjitetin e tij, e cila është larg formës ideale që përbën statusin e tij. Të gjithë e dinë se, çfarë i karakterizon format më bashkëkohore të kërkimit shkencor nuk

identifikohet dot kurrsesi me llojin tradicional të autoritetit të dijes, me autoritetin e atij që di dhe që prek dhe që operon dhe që kuron vetëm e vetëm me praninë e autoritetit të vet.

Është e mjerueshme të shohësh makutërinë me të cilën disa nga ata që e dinë se çfarë kam mësuar unë për gjithë këto vjet u vërsulen formulave të mia, për t'i shndërruar në tekste pa vlerë, me një qëllim të vetëm: të marrin kredit për to, të fitojnë pikë duke shkruar një artikull që bie në sy. Asgjë nuk do të ishte më e kundërt me çfarë ne duhej t'i ndihmonim të gjenin, dhe pikërisht formën e duhur të asketizmit, ose çfarë unë do ta quaja *destitucion*: gjendjen e analistit, në atë masë që ai është njeri si kushdo tjetër dhe si dikush që duhet ta dijë se nuk është as dije as vetëdije, por varet nga dëshira e Tjetrit, njëlloj sikurse varet nga ligjërimi i Tjetrit.

Sa kohë që nuk do të ketë analist që të më ketë kuptuar aq mirë sa të ketë arritur në këtë pikë, nuk do t'i hedhim dot ata hapa që ende na duhet të hedhim në analizë dhe që, duke rimarrë hapat e Freud-it, do ta çonin analizën përpara sërish.



## Shënime bio-bibliografike

*E para nga këto konferenca u mbajt në tetor 1967 në Qendrën Spitalore Vinatier, në Lyon; e dyta në Bordeaux, në 20 prill 1968; dhe e treta në 10 qershor 1967 në Fakultetin e Mjekësisë, në Strasbourg.*

*Një transkript i shaptilografuar i konferencës së Lyon-it u botua nga CES e psikiatrisë e Fakultetit të Mjekësisë Lyon-I, në 1981; pastaj u ribotua, me autorizimin tim, në revistën* Essaim. *Kanë qarkulluar edhe transkriptime të dy konferencave të tjera.*

*Azili i Vinatier-it, i krijuar me ligjin e 30 qershorit 1838 që kërkonte ngritjen e një klinike mendore për çdo departament, vuajti për një kohë të gjatë nga imazhi i vet negativ dhe njihej si 'Azili i Bron-it'. I reformuar pas Çlirimit të Francës, ishte bërë tashmë Qendra Spitalore Vinatier, kur Lacan-i e vizitoi. Kjo klinikë është tani qendra kryesore psikiatrike e rajonit Rhône-Alpes.*

*Filozofi Henri Maldiney, i lindur në 1912 dhe që dha mësim në Universitetin e Lyon-it për një kohë të gjatë, ishte i afërt me shkollën fenomenologjike. Puna e tij u përqendrua kryesisht me poezinë, artet e bukura dhe peizazhin Perëndimor dhe kinez.*

*Në Strasbourg kishte një grup të madh lakanianësh. Ky u formua që nga mesi i viteve 1950 e këtej, rreth Lucien Israel-it, një profesor i psikiatrisë dhe psikanalist. Ishte ideja e tij ta ftonte Lacan-in në Strasbourg.*

*Lacan-i e vizitoi Bordeaux-në me fiesë të një numri mjekësh specializantë në Spitalin Psikiatrik (CHS) Charles-Perrens. Leksioni u mbajt në një ndërtesë bashkiake përballë spitalit.*

*J.A.M.*



Përmbajtja

*Shënim* ..... 7

VENDI, ORIGJINA DHE QËLLIMI I MËSIMIT TIM ..... 9

MËSIMI IM. NATYRA DHE QËLLIMET E TIJ ..... 77

PRA, DO TË KENI DËGJUAR LACAN-IN ..... 119

*Shënime bio-bibliografike* ..... 147